



# LUSTRACIONI NË SHQIPËRI: E SHKUARA DHE E ARDHMJA

**Ilir Kalemaj, Ph.D**

**Ky botim u mbështet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.  
Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë,  
domosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.**

# **Lustracioni në Shqipëri: E shkuara dhe e ardhmja**

## **Lista e shkurtesave**

---

AIDSSH - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991

BIRN Albania - Balkan Investigative Reporting Network (Albania)

EQL - Evropa Qendrore dhe Lindore

ISKK - Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

SPAK - Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

SHISH - Shërbimi Informativ Shtetëror

## **Pasqyra e Lëndës**

Përmbledhje ekzekutive .....	4
Hyrje .....	5
Metodologjia dhe metodat .....	7
Debatet në drejtësinë transitore dhe lustracionin .....	9
Drejtësia transitore dhe lustracioni në ish-Evropën Lindore pas komunizmit .....	12
Rasti i Rumanisë .....	14
Rasti i Ukrainës .....	17
Drejtësia transitore dhe lustracioni në Shqipërinë e tranzicionit: Aparati institucional .....	18
Lustracioni në Shqipëri: Aparati ligjor .....	22
Fati i lustracionit dhe politika: Quo Vadis? .....	25
Analiza e të dhënave nga sondazhi dhe intervistat .....	28
Përfundime dhe rekomandime .....	36
Referencat .....	39

## Përmbledhje ekzekutive

Shqipëria është një ndër vendet e rralla të ish-Evropës Lindore që nuk ka kryer ende një proces të besueshëm, të pakontestueshëm dhe të plotë të lustracionit, që do të shenjonte dhe divorcin përfundimtar me të kaluarën komuniste, do të sillte de-komunistizimin e shoqërisë, purifikimin e përfaqësimit politik, pastrimin e administratës publike dhe sistemit gjyqësor, dhe një katharsis të përgjithshëm ku ajo që do të sillte vlerë të shtuar në debatin publik do të ishin idetë bashkëkohore dhe jo e kaluara e individëve të caktuar. Në fakt, në shumicën e këtyre vendeve, lustracioni përpos një obligim moral dhe burim legjitimiteti, ka shërbyer edhe si një mjet pastrimi nga ish-funksionarë të lartë publikë dhe bashkëpunëtorë të organeve të sigurimit të pushteteve moniste dhe ka çelur rrugën për zgjedhje demokratike, si dhe ka sjellë konsolidimin e shtetit të së drejtës. Ajo që e bën akoma më *sui generis* rastin e Shqipërisë, është se ishte rasti më i pastër i një sistemi totalitar përpos Bashkimit Sovjetik nën Stalinin, pra nevoja për një shkëputje me të kaluarën veçanërisht përmes lustracionit ishte e fortë.

Nga ana tjetër, ndonëse ishte e fundit ndër radhët e dominove komuniste që ranë, pati një rotacion të shpejtë sistemi, reforma të forta politike, institucionale dhe ekonomike në fillimet e saj, nuk u prek nga luftëra ndër-etnike si fqinjët e saj në ish-Jugosllavi, apo të kishte probleme komb-formuese dhe shtet-ndërtuese si rasti i vendeve balltike, ose të kishte frenim të fortë të proceseve demokratizuese si Bjellorusia apo vendet ish-sovjetike të Azisë Qendore ose Kaukazit. Akoma më paradoksale e bën rastin e Shqipërisë një retorikë gati unifikuese në spektrin politik shqiptar për de-komunistizim, ndëshkim të krimeve të komunizmit dhe nevojë për lustracion, por kur vjen puna në praktikë, ligje të tilla janë gjykuar të njëanshme, janë kontestuar fort në gjykata dhe përdorur si artileri politike ndaj kundërshtarëve ideologjikë.

Studimi në fjalë sjell përveç rastit shqiptar, ku fokusohet më së shumti, në mënyrë të sintetizuar edhe debatin mbi drejtësinë transitore në përgjithësi dhe lustracionin në veçanti në vendet e ish-Evropës Lindore, duke u përqendruar posaçërisht në rastet e Rumanisë dhe Ukrainës për disa të përbashkëta dhe veçanti që ato kanë me rastin shqiptar, për të vijuar më pas me korpusin ligjor, aparatit institucional dhe debatin politik që kanë shoqëruar përpjekjet për lustracion në këto tre dekada tranzicion demokratik në Shqipëri.

## Hyrje

---

Drejtësia transitore në Shqipëri është një proces ende i pakryer, i nisur por asnjëherë i përfunduar. Kjo për disa arsye të ndryshme, të cilat ky raport i risjell në mënyrë të strukturuar. Së pari, Shqipëria ka vuajtur nga një prej regjimeve të vetëm të mirëfilltë totalitar për më shumë se pesë dekada. Duke përjashtuar Bashkimin Sovjetik përgjatë periudhës së Stalinit, regjimi komunist në Shqipëri është i vetmi i mirëfilltë totalitar në ish-Europën Lindore dhe Qendrore, dhe për më tepër autarkik, veçanërisht pas prishjes përfundimtare me Kinën në fund vitet '70-të të shekullit të 20-të. Së dyti, drejtësia transitore në Shqipëri nuk ndoqi një formë dhe strukturë të qartë. Për shembull, të ishte modeli i një drejtësie ndëshkuese, apo të ndiqte modelin restaurues me komisionet e së vërtetës, ose dëmshpërblese e mirëfilltë. Por, modeli shqiptar nuk ndoqi asnjërin prej këtyre modele në mënyrë rigoroze dhe të mirëfilltë. Për më tepër, ndonëse tentoi forma amalgami ku përfshiheshin nga lustracioni të përmendoret, nga komisionet qeveritare të ndërkohësimit përmes vendimeve gjyqësore, asnjë prej tyre nuk pati efektin e dëshiruar dhe të arrinte njëfarë katharsisi, që do ta lejonte shoqërinë të kishte një shkëputje të menjëhershme me traumat e regjimit komunist dhe një ristart dinamik, që do ta bënte tranzicionin më të shkurtër dhe shumë më pak të dhimbshëm.

Nga ana tjetër, shumë prej këtyre tentativave për të dhënë drejtësi për viktimat e komunizmit dhe paqtuar shoqërinë në përgjithësi, shpesh kanë qenë tentativa të papërbushura plotësisht. Madje në disa raste kanë shërbyer edhe si instrumente më tepër të adresuar ndaj kundërshtarëve politikë se sa akte kurajoze dhe shëlbyese për shoqërinë. Zakonisht periudhat zgjedhore apo parazgjedhore, duke marrë parasysh se fushatat zgjedhore në Shqipëri *de facto* zgjasin të paktën gjashtë muaj përpara mbajtjes së zgjedhjeve, kanë shërbyer edhe si momente ku mekanizma të drejtësisë transitore kanë shërbyer për të përfutur kapital politik. Një shembull i kësaj janë dekoratat, përmendoret e të tjera të këtij lloji, kërkesë-faljet publike deri të gjyqet politike, që shpesh kanë përfunduar me akuza penale për çështje të rëndomta administrative ose kanë përfunduar me vendime kapitale por të ndjekura nga amnistitë, etj. Po aq joefektive kanë qenë politikisht edhe mekanizmat e dëmshpërblësës për kategorinë e ish-pronarëve dhe ish-të përndjekurve politikë, një pjesë e mirë e të cilëve kanë përfutur pak apo aspak trajtim dinjitoz financiar, ndonëse kanë kaluar 30 vjet nga përmbysja e regjimit monokratik dhe janë endur dyerve të gjykatave në pritje të stërgjatura të vendimeve gjyqësore. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me procesin e lustracionit, i cili duke qenë se është përdorur më tepër si instrument politik se sa si mekanizëm i mirëfilltë ligjor, ose nuk ka gjetur

mirëkuptim për t'u kaluar me vullnet bi-partizan politik si paketë e dakordësuar në parlamentin shqiptar, ose ka kaluar i imponuar me votat e një pale politike (mazhorancës), por ka përfunduar i rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese.



## **Metodologjia dhe metodat**

Në mënyrë që të kuptohet sa më qartë procesi i lustracionit në Shqipëri, studimi përdor qasjen krahasuese, duke analizuar disa nga praktikatat më të mira të ish-Evropës së Lindjes për të parë dhe kuptuar vështirësitë strukturore të adoptimit dhe implementimit të një kuadri ligjor që do të mundësonte adresimin e krimeve të komunizmit dhe ndalimin e ish-funksionarëve të lartë të nomenklaturës apo ish-Sigurimit për të pasur pozicione të larta në administratën publike, gjykata apo organet e përfaqësimit politik.

Studimi mbështetet në metodologjinë cilësore të trianguluar (kryqëzuar) që përbëhet nga intervistat e strukturuar dhe gjysmë të strukturuar me përfaqësues të lartë politikë, ish-funksionarë të lartë publikë, drejtues agjencish dhe institucioneve të rëndësishme, anëtarë të shoqërisë civile, gazetarë, studiues dhe ish-të përndjekur politikë. Gjithashtu, është zhvilluar një fokus grup me të rinjtë, si dhe është zhvilluar një sondazh, i cili është shpërndarë në grupe ekspertësh të fushave të ndryshme të ekspertizës, gazetarësh dhe publicistësh, studiuesish dhe ish-të përndjekur politikë. Gjithashtu, të dhënat parësore përfshijnë shqyrtim dokumentash, statistikash zyrtare, legjislacioni dhe vendime gjykatash. Këto janë ballafaquar me një numër burimesh dytësore, intervista të cituara nga shtypi i përditshëm përgjatë viteve me eksponentë të rëndësishëm të debatit mbi lustracionin, libra, artikuj studimorë, etj.

Për t'i përmbledhur disa nga gjetjet kryesore, së pari ka qenë procesi i mbledhjes së të dhënave që u mbështet në intervistimet e strukturuar dhe gjysmë-të-strukturuar me përfaqësues aktualë të mazhorancës dhe opozitës politike dhe qëndrimin e tyre rreth procesit të lustracionit, si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme si, Autoriteti i Dosjeve (AIDSSH), Muzeu Kombëtar, me të intervistuar titullarët e tyre respektivë, me gazetarë të njohur, historianë që janë marrë me të kaluarën komuniste në përgjithësi, por edhe studiues të lustracionit posaçërisht, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, ish-të përndjekur politikë, etj.

Nga ana tjetër, sondazhi i shpërndarë grupeve të interesit, duke përfshirë pedagogë të njohur të shkencave politike, sociologjisë, historisë, studiues dhe kërkues shkencorë të afirmuar, gazetarë dhe publicistë, apo institute dhe organizata jo-qeveritare që janë marrë direkt apo indirekt me lustracionin, si për shembull kujto.al, ka gjeneruar përgjigje mjaft të vlefshme dhe komplementare të atyre që kanë siguruar intervistat, në mënyrë që të kemi një tablo sa më të plotë të procesit të lustracionit, jo vetëm se si ka evoluar apo ngecur, por edhe se si

është perceptuar nga grupe të ndryshëm interesi. Po aq me vlerë janë mendimet e ndryshme përsa i përket matjes së progresit të Shqipërisë me vende të tjera të ish-bllokut komunist, dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, se si e shohin në të ardhmen e afërt mundësinë e miratimit dhe zbatimit të një ligji lustracioni. Ky i fundit ka një sfidë të trefishtë, pasi duhet të jetë i tillë që të rikuperojë kohën e humbur, të jetë efektiv në zbatim, si dhe të garantojë liritë dhe të drejtat thelbësore të njeriut, duke u bazuar dhe në vendimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Strasburgut, Komisionit të Venecias, dhe praktikave më të mira të vendeve të ish-Lindjes në periudhën pas-komuniste. Mendimet që u volën në formën e intervistave dhe sondazhit sollën pikëpamje me mjaft interes, që gjenden të reflektuara përmbledhtazi dhe në studimin aktual.

Gjithashtu, procesi i mbledhjes së të dhënave është mbështetur, mes të tjerave, te fokus grupi i ndërtuar me pjesëmarrje studentore. Këta janë nëntë ish-studentë dhe studentë aktualë në nivelet bachelor dhe master të shkencave, në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky fokus grup shërbeu si testim i njohurive mbi lustracionin te të rinjtë, interesin e tyre përkatës, por edhe si një mjet informimi duke parë nivelin jo fort të kënaqshëm të njohurive mbi procesin e lustracionit. Përdorimi i metodës së fokus grupit mundëson eksplorimin e vlerave, qëndrimeve mbi politikat e lustracionit dhe idetë e të rinjve mbi procesin e deritanishëm të lustracionit, dhe ç’duhet bërë në të ardhmen e afërt. Me nëntë studentët u krye një debat interesant dhe produktiv përmes fokus grupit, që mbart mjaft vëzhgime të vlefshme. Për rrjedhojë, përveç qëndrimeve dominante, pati edhe ide të kundërta nga shumica e pjesëmarrësve. Mendimet, gjykimet e vëzhgimet në lidhje me gjendjen e tanishme të procesit të lustracionit dhe trajektoren e tij të ardhshme ishin të drejta dhe me vlerë.

Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave përfshin përmbledhjen e të dhënave të gjeneruara nga intervistat, sondazhi dhe diskutimi i fokusgrupit, dhe shënimet e mbajtura. Analiza e të dhënave ndjek modelin e strukturuar të analizës së të dhënave të ndërtuar prej Creswell-it (Creswell, 2007). Etapat e analizës cilësore të të dhënave sipas këtij modeli përfshijnë organizimin e të dhënave, mbajtjen e shënimeve, kategorizimin e të dhënave në kategori të vlefshme e të ndara analitike, që më pas grupohen në tema të rëndësishme, dhe së fundi etapa e paraqitjes së gjetjeve në studim.

## Debatet në drejtësinë transitore dhe lustracionin

Fusha e drejtësisë transitore është sa e ndjeshme, aq edhe ende e paeksploruar. Nga ana tjetër, është gjithashtu mjaft e larmishme, duke qenë se regjimet e kaluara mund të kenë qenë naziste, fashiste, komuniste, ose nëse do i gruponim bashkë do t'i quanim regjime totalitare. Por, regjime të tjera me natyrë autoritare janë të natyrës sulltanistike, ose të tipit junta ushtarake ose post-totalitare, që gjithsesi kanë pasur pjesën e tyre të krimeve individuale dhe kolektive dhe për të cilat drejtësia transitore ka funksionuar në forma të ndryshme të testuara empirikisht. Qysh në ditët e para, në fushën teorike, por me implikime praktike, të drejtësisë transitore, ka pasur debate mes *ndëshkuesve*, të cilët argumentojnë ndjekjen penale pas shkeljeve masive të të drejtave (p.sh. Drumbl, 2007), dhe *restauruesve*, të cilët mbështeten kryesisht në mënyra "të buta" të marrëdhënies me të kaluarën, siç është tregimi i së vërtetës (Teitel, etj. 2002; Wiebelhaus-Brahm 2010). Megjithatë, të tjerë kanë shtuar gjithashtu koncepte dëmshpërblese të drejtësisë (Muddell & Hawkins, 2018).

Një temë e zakonshme në shumicën e debateve për drejtësinë transitore është se qëllimi përfundimtar është një demokraci e konsoliduar që zgjidh disi problemin e mungesës së drejtësisë dhe mbyll plagët e së kaluarës. Pa një cikël tranzicioni që përfshin nevojën për të adresuar padrejtësinë, shumica e studiuesve të fushës (si për shembull Arnould & Sriram, 2014; Magara, 2016), me të drejtë besojnë se nuk mund të supozojmë me siguri se kemi arritur në fazën e një demokracie të konsoliduar.

Udhëheqësit e shtetit shpesh janë përgjegjës për hartimin e politikave që kanë në fokus hakmarrjen e bazuar në ligj, si për shembull ndjekjet penale. Ndërsa një pjesë tjetër favorizon mekanizmat indirekt përmes mekanizmave restaurues, si për shembull komisionet e së vërtetës (ang. the truth commissions). Përkufizimi i drejtësisë transitore mbetet i diskutueshëm, por në përgjithësi i referohet mekanizmave juridikë dhe jo-juridikë që shtetet ndërmarrin pas shkeljeve të mëdha të të drejtave individuale dhe kolektive nga regjimi i mëparshëm. Këto mekanizma përfshijnë, por nuk janë të kufizuara, ndër të tjera ndjekjet penale, komisionet e së vërtetës, dëmshpërblimet, lustracionin, faljet, përmendoret, reformat institucionale, etj. Fokusi i hershëm i fushës ishte tek çështjet e lidërshpit dhe përgjegjshmërisë masive në tranzicionin demokratik. Sipas Ní Aoláin dhe Campbell (2005), kjo bëri të mundur formimin e drejtësisë kalimtare si një grup koherent narrativash dhe

ligjërimi, i cili siguroi kornizën për fushën në të ardhmen. Më vonë, fokusi u zgjerua dhe përfshiu edhe aspekte të tjera si, dëmshpërblime dhe tregim të së vërtetës, pajtim, falje, shërim, etj. (Stover & Weinstein, 2004; Borer, 2006).

Debati midis nevojës për gjyqet si arma kryesore e trajtimit të së kaluarës kundrejt komisioneve të së vërtetës, është një nga dilemat ende të pazgjidhura të fushës (Hayner, 2002; Aukerman, 2002). Ky përbënte në thelb debatin midis drejtësisë ndëshkuese dhe drejtësisë restauruese. Por avokatët e së parës, veçanërisht ata që mbështesin lustracionin si mjetin më efikas të drejtësisë ndëshkuese, së bashku me gjyqet, theksojnë se pa një katarsis të tillë, është pothuajse e pamundur të kapërcehen plagët e së kaluarës dhe të metamorfozohen drejt një demokracie të konsoliduar. Ndaj, dhe lustracioni në veçanti merr një rol qendror në këtë studim.

Përkundrazi, drejtësia restauruese dëshiron të krijojë dhe mbyllë plagët e së kaluarës duke rivendosur lidhjet e komunitetit dhe duke ndërtuar një të ardhme të bazuar në një ndjenjë të zakonshmërisë (Zehr, 2002). Kështu, drejtësia restauruese, siç e thotë një autor, kërkon "transformimin e faktorëve subjektivë që dëmtojnë bashkësinë, të tilla si zemërimi, pakënaqësia dhe dëshira për hakmarrje" (Amstutz, 2006, faqe 166-167). Çdo përgjigje ndaj një prishjeje të tillë kolektive duhet të kërkojë të rivendosë strukturën themelore të shoqërisë duke përfshirë viktimën, shkelësin dhe anëtarët e komunitetit. Parimet e drejtësisë restauruese në përgjithësi janë bërë forca morale udhëheqëse pas zhvillimit të komisioneve të së vërtetës pas vrasjeve masive, krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të mëdha të të drejtave të njeriut. Ndër disa nga përfitimet e komisioneve të së vërtetës janë eliminimi i aftësisë së një regjimi për të mohuar të vërtetën (Hayner, 2011, f. 22), duke i dhënë kështu drejtësi viktimave dhe duke e bërë më të lehtë faljen dhe ecjen përpara drejt pajtimit të mundshëm.

Së fundmi, ne kemi konceptin e drejtësisë dëmshpërblyese. Ky koncept përqendrohet në njohjen që marrëdhëniet njerëzore kanë vuajtur shumë si rezultat i një lloji regjimi ose një konflikti të veçantë dhe këto lidhje duhet të riparohen (Muddell & Hawkins, 2018). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vendet që kanë vuajtur në të kaluarën e tyre të ngushtë nga gjenocidi, krimet e luftës ose mizoritë e tjera masive, dhe duhet të kalojnë një proces të katarsis. Kështu, riparimi zakonisht është i përqendruar në përpjekjen për ta zhbërë dëmin ndaj viktimës. Kjo nuk mund të bëhet pa zbatuar rendin e ligjit dhe institucionet e forta, që do të jenë në gjendje të adresojnë të kaluarën në një mënyrë objektive.

Institucionet funksionale, përgjegjshmëria më e madhe dhe sundimi i ligjit janë shumë të kushtëzuara me shpejtësinë dhe cilësinë e procesit të demokratizimit. Një tranzicion i shpejtë dhe pa ekuivok nga sundimi autoritar dhe ekonomia e

planifikuar drejt demokracisë liberale dhe ekonomisë së lirë të tregut gjeneron apriori nevojën për kushtetutshmëri më të fortë dhe sundimin e ligjit, përndryshe reformat demokratike do të dështojnë të zhduken. Kështu që, drejtësia transitore është e rëndësishme për të kuptuar, matur dhe vlerësuar se si ndikon në proceset e demokratizimit. Kohët e fundit, ndikimi në demokraci është bërë gjithnjë e më i qartë (Thoms, Ron & Paris, 2010). Në të vërtetë, për shumë prej këtyre studimeve, arritja e një regjimi demokratik liberal që respekton të drejtat civile dhe politike është treguesi kryesor i suksesit.

Format e hershme dhe të shpejta të adresimit të së kaluarës janë të rëndësishme për konsolidimin demokratik sepse, pa një katarsis të përgjithshme dhe reflektime mbi diktaturat dhe krimet e tij kundër lirive individuale dhe dinjitetit njerëzor, shoqëria nuk mund të funksionojë normalisht dhe përparimi do të jetë i vështirë për t'u arritur. Një studiues vuri në pah rëndësinë e mekanizmave të veçantë të drejtësisë transitore, kur vuri në dukje se "sanksionet jo-kriminale, të tilla si spastrimet, lustracioni dhe qasja e publikut në dosjet e sigurisë, janë thelbësore për elementin e reformës demokratike..." Kritiz (1999, f. 19-20 ). Prandaj, është pretendimi i këtij punimi që pa zbatim të shpejtë dhe të suksesshëm të drejtësisë transitore që adreson të kaluarën diktatoriale, tranzicioni do të pësojë pengesa dhe konsolidimi demokratik nuk mund të arrihet. Kështu, pa një pakt shoqëror që merr parasysh tërë trashëgiminë e së kaluarës, shoqëria thjesht nuk mund të ecë përpara. Pa përgjegjësi, nuk mund të ketë falje. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të merren parasysh masat e drejtësisë transitore, dhe posaçërisht procesit të lustracionit, si ndryshore të rëndësishme në studimin e formës së demokracisë në shoqëritë post-autoritare.

## **Drejtësia transitore dhe lustracioni në ish-Evropën Lindore pas komunizmit**

Me përjashtim të Bashkimit Sovjetik përgjatë periudhës kur në pushtet qe Stalini, Shqipëria totalitare dhe regjimi totalitaro-sulltanist i Rumanisë së Çausheskut ishin ndër më brutalët (Stepan & Linz, 1996). Sidoqoftë, kohët e fundit 70 përqind e rusëve të sotëm kanë shprehur mbështetje për regjimin e Stalinit dhe ndihen nostalgjikë (Arkipov, 2019), ndërsa Shqipëria (krahas Rumanisë) është ndër dy vendet me pikëpamjet më të larta negative ndaj regjimit të dikurshëm në Evropën Lindore (Kajsiu, 2016). Kjo natyrisht lidhet me efektet e shtypjes totalitare që impononte një legjitimitet fallco dhe shkurajonte çdolloj forme disidence nga këto vende. Siç vëren F. Tarifa, pëlqimi për autoritetin e shtetit-parti nuk duhet të konsiderohet si tregues i legjitimitetit për sundimin komunist, "madje edhe midis atyre që u pajtuan, shumë e bënë këtë sepse e konsideruan koston e rezistencës shumë të lartë ... bazuar pjesërisht në përvojat e dhimbshme të atyre të përkushtuar anti-komunistë që guxuan të shprehnin protestën e tyre" (Tarifa, 1997). Kjo natyrisht la gjurmë të thella në psikikën kolektive dhe ndikoi në një pikëpamje të gjerë negative ndaj regjimit të dikurshëm, sikundër vihet re në rastet e Rumanisë dhe Shqipërisë. Veçanërisht te kjo e fundit, e cila nuk ka kryer ende një proces të mirëfilltë lustracioni që do të mundësonte një katharsis shoqëror, një pastrim të politikës dhe institucioneve, do të rriste besueshmërinë e tyre në publik dhe do të bënte më funksional shtetin e së drejtës.

Shpejtësia e proceseve të tranzicionit dhe demokratizimit në Evropën Lindore dhe Qendrore varion nga Shqipëria problematike deri në Slloveninë dhe Estoninë e suksesshme. Nga të dhënat empirike, Estonia figuron si një demokraci plotësisht e konsoliduar me tregues të ulët të drejtësisë transitore. Të tjerë, siç janë vendet e Vishegradit, kishin në start një demokratizim të shpejtë dhe një tranzicion të qetë, por tani duket se po luftojnë me konsolidimin demokratik. Mendoj dhe gjetkë kam argumentuar se drejtësia kalimtare mund të jetë lidhja që mungon për të kuptuar pse disa vende arrijnë pjekurinë më të shpejtë demokratike se të tjerët (Kalemaj 2019). Sidoqoftë, unë e shoh këtë marrëdhënie në terma korrelacionale dhe jo si shkakësore për vendet e ish-Evropës Lindore.

Ekziston një literaturë gjithnjë në rritje për drejtësinë transitore në Evropën Lindore. Për shembull, një përmbledhje autorësh e botuar nga Lavinia Stan (2009), e cila merr parasysh raste të suksesshme dhe të pasuksesshme të vendeve evropiane ish-komuniste, analizon synimet e politikës dhe shkallën e zbatimit të politikave

të caktuara, si për shembull reformat e lustracionit. E njëjta gjë si kjo valë e tretë e tranzicioneve në EQL ndryshonte shumë nga një vend në një vend, drejtësia transitore gjithashtu ka ndryshuar. Ndërsa disa vende bënë përparim të shpejtë drejt demokratizimit, veçanërisht në dekadën e parë pas rënies së komunizmit, kohët e fundit disa ngelën mbrapa. Kjo megjithë integrimin e suksesshëm evropian të disa prej këtyre vendeve, ndërsa të tjerët thjesht kanë ngecur siç mund të dëshmojë shembulli i vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për shembull, Gjermania Lindore ishte shumë larg nga grupi i vendeve të tjera të EQL, sepse u asimilua plotësisht nga Gjermania Perëndimore, e cila nga ana tjetër prodhoi përgjegjësi të lartë politike dhe procese të plota lustracioni qysh në krye të herës. Ky është një rast në mënyrën se si zbatimi i hershëm dhe i suksesshëm i masave të drejtësisë transitore ndikon në konsolidimin demokratik. Republika Çeke është një tjetër rast po aq i suksesshëm. Në fakt Republika Çeke kaloi ligjin e lustracionit qysh në vitin 1991, Hungaria nga ana tjetër në 1994, ndërsa Polonia iu bashkëngjiti reformave të lustracionit të vendeve të bllokut të Vishegradit, sikundër dhe quhen, vetëm në 1997-ën (Williams, 2007).

Rumania, nga ana tjetër, nuk arriti të “zbatojë lustracion radikal dhe gjykimet gjyqësore kanë qenë të pakta në numër dhe të përcaktuara në procedurë” (Stan, 2009), megjithatë ajo ka dënuar me forcë përmes autoritetit më të lartë të shtetit mizoritë e komunizmit regjimi, pas një raporti nga Komisioni Presidencial për Analizën e Diktaturës Komuniste në Rumani (Vierita, 2012), duke u diferencuar kështu nga shumica e vendeve të Ballkanit, si dhe nga disa nga fqinjët e saj veriorë. Por, Rumania ka vuajtur për një kohë të gjatë nga një fillim i ngadalhtë dhe një demokratizim i vonë, duke bërë kalimin e parë të vërtetë të pushtetit nga (ish) komunistët në opozitë vetëm në 1996 (Marginean, 1997). Disa autorë madje argumentojnë se “Rumania nuk ka përmbushur ende valën e saj të dytë të demokratizimit” (Craciun, 2017), ndërsa ende filloi të zbatojë, ngadalë në fillim dhe më pas me shpejtësi, masat e saj të drejtësisë transitore, të cilat ndihmuan në rindërtimin e strukturës sociale në një vend që erdhi nga një rrugë e gjatë nën totalitarizëm. Do ta zhvilloj çështjen e Rumanisë në mënyrë të plotë në seksionin vijues. Bullgaria ndërkohë ka shumë ngjashmëri me rastin e Rumanisë, me qeveritë e njëpasnjëshme që shtynë procese të tilla si lustracioni, por kritikohen njëkohësisht nga grupi i të drejtave të njeriut si shkelje të të drejtave individuale duke e zhvendosur fajin individual te faji kolektiv. Gjithashtu, Bullgaria ndan të njëjtat tipare demokratike si Rumania në shumë aspekte.

## Rasti i Rumanisë

Një nga rastet më të mirëdokumentuara të drejtësisë transitore në përgjithësi, dhe lustracionit në veçanti, në Evropën Lindore ish-komuniste është Rumania. Një nga karakteristikat dalluese në rastin e Rumanisë është se ekziston një hendek i dukshëm midis elitës politike dhe shoqërisë civile. Kjo e fundit kërkon që të ketë një ndarje të pastër me të kaluarën dhe ka kërkuar në vijimësi një proces lustracioni më të fortë se ka pasur vullnet klasa politike. Kjo është ajo që thekson një studiuese kur përmend Komisionin Tismăneanu, të krijuar në atë kohë nga Presidenti Basescu, i cili përfshinte disa grupe të të drejtave civile dhe përfundoi një raport shkencor që detajonte krimin e "periudhës 1945-1989 në një mënyrë sistematike dhe objektive" ( Stan 2009, fq. 25).

Nga ana tjetër, gjykatat që merreshin me krimet komuniste, autorët e tyre dhe bashkëpunëtorët e tyre kanë qenë një tipar i përbashkët i zbatuar nga të gjitha vendet e ish-Lindjes komuniste. Ato shpesh krahasohen nga niveli i suksesit se sa rol ato kishin luajtur për një tranzicion të shpejtë dhe të suksesshëm dhe sa fort kishin ndikuar në përshejtimin e demokratizimit në një vend të caktuar. Në Rumani ne vërejmë një lloj të veçantë gjykate, të ashtuquajturat "Gjykatat e Opinioneve". Ato kishin një karakteristikë tjetër nga gjykatat e zakonshme, ishin gjykata të qytetarëve të Rumanisë, dhe të pangjashme me vendet e tjera të ish-Lindjes komuniste (Klinghoffer dhe Klinghoffer, 2002). Ato u krijuan për mbajtjen përgjegjëse të ish-nomeklaturës së regjimit që ishin përgjegjës për krimet kundër njerëzimit, edhe pse për fat të keq këto gjykime morën pak vëmendje nga shoqëria rumune apo qytetarët e saj që jetonin jashtë vendit. Ato ishin kryesisht simbolike dhe nuk kishin "qëndrim ligjor", kështu që arritën sukses shumë të kufizuar, siç shpjegon Stan (2012).

Në lidhje me përpjekjet dhe suksesin e përgjithshëm të lustracionit, Rumania filloi relativisht vonë, vetëm në gjysmën e dytë të viteve 90-të (Stan, 2013), dhe nuk bëri sa duhet për ta klasifikuar si një nga rastet e suksesshme të ish-Evropës Lindore. Siç argumenton e njëjta autore, "shoqëria civile ka promovuar lustracionin pa bindur elitat politike për ta zbatuar plotësisht atë" (Stan, 2013). Por, përsa i përket angazhimit të shoqërisë civile, Rumania ka treguar se është shumë më aktive se rasti shqiptar. Në Shqipëri nuk ka pasur ndonjë aktivizim të veçantë nga shoqëria civile për të kryer një proces lustracioni të shpejtë dhe efektiv. Ka pasur zëra të caktuar, por jo në mënyrë të organizuar si në Rumani. Në rastin rumun kemi të bëjmë me një shtysë nga poshtë-lart për reforma të tilla, ndërsa në Shqipëri iniciativat për lustracionin kanë qenë më tepër një ndërmarrje nga lart-poshtë,



duke pasur parasysh dobësinë strukturore të aktorëve të shoqërisë civile dhe politizimin e debatit në lidhje me miratimin dhe zbatimin e masave të tilla.<sup>1</sup>

Nga ana tjetër, Rumania fillimisht kishte një shoqatë aktive të të burgosurve politikë që me kohën filloi të rrënohet, e quajtur "Asociația Foștilor Deținuți Politici din România" dhe e themeluar në vitin 1990 në Bukuresht, e cila kishte degë në të gjithë vendin dhe një anëtarësi që raportohet se është zvogëluar nga 98,700 në 1990 në 45,000 deri në vitin 2000 (Stan 2013). Në emër të kësaj aleance të ish-të burgosurve politikë, senatori Kostandin Ticu Dumitrescu:

promovoi lustracionin përmes Projektligjit të tij për Qasje në Dosje dhe Zbulimin e Sekretariatit si një Polici Politike, i cili në versionin e tij origjinal i lejoi qytetarët të lexojnë dosjet e tyre të përpiluara nga Securitate dhe të pyesnin publikun për zyrtarë apo kandidatë për deputetë të zbuluar si ish-agjentë sekretë, në mënyrë që të çonin në heqjen dorë nga postet e tyre ose nga gara elektorale. Pas debateve të hidhura, Parlamenti hoqi projekt-ligjin për përcaktimet e tij të lustracionit. Kur projektligji u miratua si Ligji 187/1999, varianti i Dumitrescut u ndryshua aq shumë nga amendimet e bëra sa ai hoqi dorë nga autorësia e ligjit (Stan 2000).

Periodha më e suksesshme në lidhje me thirrjet për domosdoshmëri të lustracionit në Rumani ishte midis 2005-07, ku Liberal-Demokratët sunduan vendin. Siç kujton Stan (2011), "në 2006 gazetarët rumunë filluan një fushatë të Zërave të Pastër për të identifikuar agjentët sekretë në mesin e reporterëve të shtypit, gazetarëve në përgjithësi dhe moderatorëve. Si përgjigje, ligjvënësit liberalë paraqitën një projekt-ligj për lustracionin, ndërkohë opozita iu kundërpërgjigj me propozimin e vet legjislativ për anti-nomenklaturën, ndërsa intelektualët, akademikët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile u bënë thirrje spiunëve të dikurshëm dhe aktualë të zbulojnë lidhjet e tyre me shërbimet e inteligjencës komuniste dhe postkomuniste, ndërkohë që shumë politikanë pranuan që kishin qenë spiunë ose bashkëpunëtorë të ish-Securitate. Më e rëndësishmja, grupet e shoqërisë civile bindën udhëheqësit e Dhomës së Deputetëve që së bashku të organizojnë një debat publik me temë "Lustracioni: Parimet ose Instrumentet" më 25 maj 2006. Përveç ligjvënësve dhe qytetarëve të zakonshëm, përfaqësues të 10 grupeve të shoqërisë civile, përfshirë Shoqatën Timișoara, Aleancën Qytetare dhe Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë, deklaruan qëndrimin e tyre për këtë praktikë

---

1 Kur vjen fjala te masat e lustracionit në veçanti, të dyja vendet kanë dështuar në krahasim me vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore (p.sh. Republika Çeke apo Gjermania Lindore), por edhe ndër vendet e Vishegradit kishte ndryshime të mëdha. Për shembull, "ndërsa në Republikën Çeke 10,000 njerëz humbën pozicionet e tyre për shkak të lustracionit, në Hungari dhe Poloni u prekën më pak se 500 vetë" (Stan, 2009).

të rëndësishme të lustracionit. Kështu, në Rumani u bë një thirrje e fortë nga shoqëria civile për lustracion dhe forma të tjera të thyerjes radikale me të kaluarën komuniste, por fillimisht kishte pak vullnet politik përmes miratimit të legjislacionit për të ndjekur gjyqe të vërteta apo procese që do të ndalonin vazhdimisht garimin nga ish-anëtarët e nomenklaturës, etj.

Gjyqet e Rumanisë u hapën me gjyqin e shfaqjes së ish-diktatorit Çaushesku dhe gruas së tij Elena, dhe përfunduan me të pushkatuarit e tyre brenda një harku të shkurtër kohe. Gjyqi i fundit në Rumani ishte kundër Ion Llesku, ish-komunist i kthyer në demokrat, përgjegjës për gjyqin kundër Çausheskut, i cili në prill të vitit 2019 akuzohej për krime kundër njerëzimit për ngjarjet që ndodhën në 1988, së bashku me zëvendës kryeministrin Gelu Voican Voiculescu dhe ish-gjeneralin e Forcave Ajrore Iosif Rus. Gjyqet ndaj ish-anëtarëve të nomenklatura komuniste kanë filluar që nga viti 1989. Shoqëria civile bëri thirrje për gjykime të tilla të shpejta si një shkëputje e pastër me të kaluarën e afërt dhe një mënyrë për të ecur përpara me vendosjen e sundimit të ligjit. Për shembull, qysh në vitin 1991, Shoqata e ish-të burgosurve politikë u dorëzoi prokurorëve një listë të autorëve të famshëm të komunizmit, duke përfshirë nënkryetarin e Siguritate Alexandru Nicolschi dhe Ministrin e Sigurisë së Shtetit Alexandru Drăghici. Në vitin 1998, emri i Gheorghe Crăciun, ish-kreu i burgut Aiud (1958-1964), u shtua në listë. Të tre të akuzuarit vdiqën para se gjykatat të dëgjonin çështjet e tyre (Muraru, 2011).

Grupi i ombrellës së shoqërisë civile “Aleanca Civile” thirri qysh në mars 1991 në “Deklaratën për Pajtimin Kombëtar”, që “drejtuesit e Partisë Komuniste, por jo të katër milion anëtarët e partisë, duhet të konsiderohen moralisht përgjegjës” për krimet komuniste. Ndërsa “çdo referencë ndaj një personi duhet të përfshijë veprimet e tij apo të saj, jo thjesht anëtarësimin në parti, ish-anëtarët e Komitetit Qendror, aktivistët e partisë dhe agjentët e Siguritate duhet të ndalohen të pushtojnë poste publike deri në vitin 2000” (Stefănescu, 1995, f. 130-131).<sup>2</sup>

2). Për më tepër, Rumania ndërmori masa restauruese si Komisioni i së Vërtetës, i themeluar në dekadën e dytë të viteve 1990 (Stan, 2012), si dhe mjete dëmshpërbluese si rehabilitimi dhe kompensimi financiar, që filloi qysh në 1991 dhe akoma vazhdon edhe sot.

## **Rasti i Ukrainës**

Projektligji ukrainas për lustracionin u propozua më shumë se dy dekada pasi ligje të tilla u miratuan nga (ish-) Çekosllovakia,<sup>3</sup> Hungaria dhe Polonia. Qëllimi i projektligjit ukrainas është shumë më i gjerë se çdo shtet evropian kufitar me të. Dhe, përkundër deklaratës së projektligjit në preambulën e tij se ai kërkon të ndihmojë “krijimin e kushteve për zhvillimin e një qeverie të re shtetërore në përputhje me standardet evropiane”, drafti në shumë mënyra shkelte standardet e Këshillit të Evropës për lustrimin (Vitvitsky, 2014). Në vend që të administrohej nga një komision i krijuar posaçërisht e i pavarur i qytetarëve të shquar, siç drejtohet nga Këshilli i Evropës, projektligji ukrainas parashikonte në nenin 5 që lustrimi do të kryhej nga kreu i agjencive përkatëse. Kjo ngriti të gjitha llojet e shqetësimeve rreth arbitraritetit të mundshëm, zbatimit selektiv, lidhjeve të nepotizmit, etj.<sup>4</sup>

Konflikti i interesit dhe nepotizmat janë kësisoj të pashmangshëm veçanërisht në një vend si Ukraina, që ka probleme thelbësore me demokratizimin dhe shtetin e së drejtës. Ndaj në 19 qershor 2015, Komisioni i Venecias lëshoi opinionin e tij përfundimtar mbi ligjin e lustracionit në Ukrainë. Ndryshe nga opinioni i ndërmjetëm, që ishte mjaft kritik dhe thoshte shprehimisht që “fajësia duhej provuar në mënyrë individuale dhe rast pas rasti”, opinionin përfundimtar ishte disi më i zbutur, i jepte më shumë kompetenca në zbatimin e ligjit diskrecionit të qeverisë, nuk i quajti më lustrimet si procese diskriminuese, dhe madje hoqi dorë nga kërkimi i provave për përgjegjësinë individuale (Bobrinsky, 2015).

Gjithsesi ligji hasi në probleme thelbësore në procesin e zbatimit, të tilla si shtyrja jashtë afateve e proceseve të lustrimit në praktikë, transferimi në një pozicion më të ulët në shkallën hierarkike të karrierës brenda administratës publike për të favorizuar individë me lidhje të forta brenda sistemit, etj. (Piasecka and Drik, 2015).

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se, “në janar 2015, Komiteti i Lustracionit Civil publikoi rezultatet e analizës së tij, sipas të cilave Prokuroria e Përgjithshme ishte sabotatori më i madh i lustracionit”, pra kemi pasur ndërhyrje të forta nga brenda sistemit të drejtësisë për të minuar në praktikë procesin e lustracionit. Kjo ndikon jo pak në dobësimin e institucioneve, kërcënon besimin te shteti i së drejtës, pengon demokratizimin me ritme të shpejta në rastin e Ukrainës dhe cënon shpresën e qytetarëve të një proces efektiv dhe i besueshëm i lustracionit (Piasecka and Drik, 2015).

3). Mandej të ndarë në dy shtete të ndryshme, Republika Çeke dhe Sllovakia duke filluar nga 1 janari 1993.

4). *Ibid*

## **Drejtësia transitore dhe lustracioni në Shqipërinë e tranzicionit: Aparati institucional**

Traumat e komunizmit totalitar në Shqipëri nuk mund të tejkalohen pa një proces të mirëfilltë lustracioni që do të adresonte pastrimin e administratës dhe nëpunësve publikë nga ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, që ende vijojnë të punojnë të patrazuar në to, si dhe në organet ligjzbatuese. Mekanizmi kryesor i Hoxhës për të kontrolluar jetët e shqiptarëve ishte Sigurimi dhe rrjeti i tij mbikëqyrës. Sigurimi kishte rreth 15,000 bashkëpunëtorë, ndër të cilët 1,000 agjentë dhe 11,000 informatorë në të gjithë Shqipërinë. Spiunët e tij ishin të shpërndarë nëpër Tiranë: në hotele, ambasada, zyra postare, dhe madje edhe dyqane ushqimore (Mejdini & Ristic 2018). Shqipëria ende nuk e ka kryer një proces të mirëfilltë lustracioni, dhe ky i fundit ka ngelur në tentativë. Në fakt, edhe nismat institucionale të ndërmarra për të realizuar procesin e lustracionit kanë rezultuar në përgjithësi jo efektive (Abdurrahmani, 2018).

Gjithashtu duhet nënvizuar se shumë nga dosjet e sigurimsave ose ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit janë zhdukur ende pa filluar tranzicioni demokratik. Sikundër shkruan Kastriot Dervishi në studimin e tij që pritet të dalë së shpejti *Lustracioni dhe arkivi për të në Shqipëri*, "referuar dosjeve origjinale dhe dhënave në regjistra, në vitet 1980-1992 ishin asgjësuar gjithsej 39,519 dosje të kartotekave të degëve të punëve të brendshme në rrethe (vetëm në vitet 1989-1991 ishin asgjësuar 29,503 dosje). Përrjashtimisht nga kjo statistikë, të dhënat nga Durrësi fillonin prej vitit 1974. Asgjësimi vlerësohej i rregullt, pra me lista veçimi në rreth 20 përqind të rasteve". Pra, fakt është që shumë nga dosjet kishin filluar të eliminoreshin qysh një dekadë a më shumë para rënies së komunizmit, dhe çdo proces lustracioni në Shqipëri do të ishte i cunguar, aq më tepër kur është i vonuar me rreth tre dekada, nëse marrim për pikënisje kohën e fillimit të pluralizmit demokratik.

Drejtësia transitore në Shqipërinë post-komuniste është një temë që shpesh anashkalohet dhe ende nuk është hulumtuar siç duhet. Një nga analizat që ka evidentuar dështimin e një procesi adekuat të drejtësisë transitore në Shqipërinë post-komuniste ka qenë nga Austin & Ellison (2008), ku ata argumentojnë se tre faktorët kryesorë që ndikuan në dështimin e këtij procesi ishin kultura politike e vendit, ndikimi i regjimit komunist, dhe më e rëndësishmja "mungesa e vullnetit politik nga udhëheqja politike shqiptare për t'u shkëputur nga e kaluara e

tij komuniste". Ata këmbëngulin se vendi dështoi veçanërisht me procesin e lustracionit, të cilin klasa qeverisëse në vijimësi e ka konsideruar më tepër "si një mjet politik për të shtypur opozitën dhe për të konsoliduar fuqinë e saj". Kështu, lustracioni nuk është bërë me qëllim që mos të kishim një shkëputje përfundimtare me të kaluarën, duke mbajtur përgjegjës autorët e krimeve të komunizmit në mënyrë që të arrihet një katarsis që do të lejonte shoqërinë e traumatizuar të ecë përpara.

Në vend të kësaj, ky proces (i përealizuar) është parë shpesh nga elita politike si një mjet politik dhe selektiv për të shpëtuar nga kundërshtarët politikë, ndërsa konsolidojnë pushtetin e tyre. Për autorët, kjo ka ndikuar në "procesin e drejtësisë transitore në Shqipëri që është bërë shumë i politizuar dhe u përdor nga politikanët për përfitime politike, e cila përfundimisht çoi në humbjen e besimit nga publiku i gjerë, duke mos arritur të shkëpusë skenën politike shqiptare nga e kaluara e saj komuniste" (Austin & Ellison, 2008).

Shqipëria qëndron në kontrast të theksuar edhe me fqinjët më të afërt që ndajnë të kaluarën e përbashkët, duke pasur parasysh trajektoret e ndryshme paskomuniste, ku Jugosllavët ishin të përfshirë në ndërtimin e identitetit dhe luftërat e konflikteve etnike që kanë munguar në Shqipërinë fqinje. Shqipëria ka qenë historikisht një vend i paradokseve të tilla. Ngjashëm me faktin që ajo kishte tranzicionin më të vështirë drejt konsolidimit demokratik, edhe pse kishte një shoqëri mono-etnike, dhe nuk u përfshi në konflikt etnik irredentist dhe seksesionist të Jugosllavisë fqinje (Kalemaj, 2014).

Sa i përket drejtësisë transitore në përgjithësi dhe lustracionit në veçanti, Shqipëria nuk është as skenari më i mirë, as më i keq. Në të vërtetë, shoqëria civile, media dhe qytetarë aktivë kanë qenë në pararojë në krahasim me klasën politike, e cila shpesh për arsye të vogla ose konflikt interesi në përgjithësi ka qenë pengesa kryesore për një proces të shpejtë dhe të përfunduar të drejtësisë transitore. Ndër masat që ka ndërmarrë Shqipëria, veçojmë ndër të tjera rehabilitimin dhe kompensimin financiar të ish-të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, që ka filluar në vitin 1991, menjëherë pas rënies së regjimit komunist, por për shkak të kufizimeve të burimeve financiare vazhdon edhe sot e kësaj dite. Ndër disa masa të vona mund të përmendim vetingun e ish-zyrtarëve dhe bashkëpunëtorëve të Sigurimit që vazhdon ndërsa flasim. Këta ish-zyrtarë dhe bashkëpunëtorë duhet të kalojnë filtrin e Autoritetit të Dosjeve, përpara se të zgjidhen ose emërohen në poste shtetërore me fuqi të lartë.

Një nga paradokset në rastin shqiptar është se menjëherë pas komunizmit, disa gjykime të shpejta mbi ish-anëtarët e nomenklaturës komuniste dhanë dënime pa

kuptim, bazuar në akuza qesharake (Beshiri, 1998). Për shembull, ata dënuan gruan e diktatorit Hoxha dhe disa anëtarë të ish-Byrosë Politike për abuzime financiare, të ashtuquajturat “gjyqe kafeje”, duke u përqendruar tek shpërdorimet financiare për pije apo ushqime, në vend që t’i dënonin për krime kundër njerëzimit, etj. Këto vendime të hershme u korrighuan disi më vonë, kur në vitin 1996 me Ligjin për Gjenocidin, ata u dënuan për herë të dytë. Për mbështetësit kjo ishte gjëja e duhur, ndërsa për kritikët ato ishin akuza të motivuara politikisht (Beshiri, 1998). Kështu, ata u spastruan në vitet e para të post-komunizmit, sepse jo vetëm kishin mbështetur diktaturën në mënyrë aktive, por kishin qenë eksponentë të lartë të saj duke kryer dhe krime kundër njerëzimit. Shumica e tyre, sidoqoftë, përfituan nga amnistia e vitit 1997.

Nga ana tjetër, *përkujtimet* kanë ndodhur rregullisht, megjithëse shumë më tepër pritë, për shembull duke pastruar librat nga lentet ideologjike, si dhe të përfshijnë atë pjesë të popullatës që u trajtua padrejtësisht, por dhe ata intelektualë dhe politikanë që u spastruan për shkak të bindjeve ideologjike nga regjimi komunist. Shqipëria vuajti gjithashtu nga gjyqe shumë të kufizuara që ndodhën vetëm pas regjimit komunist, mungesë falje të vërtetë, mungesë lustracioni, etj. Si një nga shembujt më të hershëm të drejtësisë restauruese në çështjen shqiptare ishte fjalia e ish-Presidentit Berisha, menjëherë pas rënies së komunizmit, në vitin e parë të tranzicionit, “ne jemi të gjithë bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës” (Berisha, 2018). Kjo thënie është cituar shpesh si nga kritikët nga e djathta, që theksonin se nuk ishte bërë sa duhet në këtë periudhë të hershme për të prishur lidhjet me të kaluarën totalitare, ashtu dhe nga e majta, që e panë një deklaratë të tillë përmes prizmit ideologjik.

Një tjetër shembull i drejtësisë restauruese në Shqipëri ishin *komisionet e së vërtetës*, por me sukses shumë të kufizuar si një instrument drejtësie transitorë që ndikon në procesin e demokratizimit. Komisioni shqiptar i së vërtetës, Komisioni Bezhani, kishte si qëllim kryesor hapjen e dosjeve të anëtarëve të rangut të lartë të administratës së kaluar dhe parandalimin e tyre për të mbajtur poste të zgjedhura gjatë tranzicionit demokratik. Në fakt, ishte shumë i kontestuar dhe disi sabotuar qysh prej fillimi të tij. Në përgjithësi, me përjashtimin e vetëm të Kilit dhe Afrikës së Jugut, ka shumë pak prova për komisionet e së vërtetës që kontribuojnë në një demokratizim të suksesshëm në përgjithësi (Brahm, 2019). Shqipëria nuk mund të ketë qenë përjashtim nga rregulli, duke pasur parasysh edhe pengesat e saj të përgjithshme, ndër të cilat ishte antagonizmi i lartë politik që ka shoqëruar tranzicionin e tij të trazuar (Kalemaj 2017).

Sa i përket mekanizmave *dëmshpërblyes*, Shqipëria ndërmori rehabilitimin e parë përmes Ligjit për Amnisti në 1991. Pas grevës së urisë nga ish-të burgosurit e

të përndjekurit politikë, Ligji tjetër i Pafajësisë i çliroi këta (ish) të burgosur nga çdo akuzë e rreme bazuar në qëndrimet e tyre ideologjike të mëparshme. Por, Shqipëria kurrë nuk përdori asnjë formë të kthimit të pronave për ish-të burgosurit politikë, dhe arsyeja për këtë ishte zbatimi i Ligjit të ri 7501, që shpërndante tokën në mënyrë të barabartë. Ndër masat e tjera dëmshpërblyese që u morën me rëndësi ishte kompensimi financiar përmes letrave me vlerë të lëshuara nga qeveria, të cilat së shpejti u bënë të pavlefshme, por në fillim mund të shërbenin për privatizimin e disa prej ndërmarrjeve publike. Lidhur me gjyqet e verifikimit, siç janë quajtur, për të vërtetuar vuajtjet e vërteta të ndërgjegjes nën regjimin e mëparshëm dhe mënyrat e kompensimit të tyre, kishte disa forma për t'u marrë me të. Së pari, për ata që u njohën me vendim gjykate, familja do të përfitonte kompensimin financiar. Së dyti, ishte kategoria e të burgosurve politikë. Së treti, kategoria e personave të ekzekutuar pa një urdhër gjykate pas identifikimit të trupave dhe të dhënave të marra nga familjarët dhe dëshmitarët. Në çdo rast ne po flasim vetëm për kompensimin financiar, por jo edhe kthimin e pronave.

## Lustracioni në Shqipëri: Aparati ligjor

Përprjekjet e para për të pasur një lloj fillim-procesi të drejtësisë transitorë në Shqipëri kanë qenë që në shtator 1991 me Ligjin nr.7541, Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që u kërkonte falje dhe shpallte të pafajshëm personat që "kanë qenë akuzuar, proceduar, dënuar, burgosur, internuar dhe persekutuar gjatë 45 viteve për dhunim të të drejtave politike, civile e sociale, morale dhe ekonomike...". Më pas kemi Ligjin nr. 7666, të datës 26 janar 1993, Për krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë dhe për një ndryshim në ligjin nr. 7541, datë 18.12.1991 "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë", i cili mund të konsiderohet ligji i parë i "lustracionit" në Shqipëri. Përmes këtij ligji ngrihej një komision i posaçëm për t'i hequr liçencën e avokatit të gjithë atyre që kishin qenë punonjës apo bashkëpunëtorë të shërbimit sekret komunist (Sigurimi). Argumenti "zyrtar" ishte se duheshin "spastruar këta ish-gjykatës dhe prokurorë", të transformuar në avokatë privatë, të cilët për shkak të largimit përmes nenit 24/1 të Kodit të Punës, kishin filluar të "jetonin mirë me fitimet si avokatë". Ndërkohë, më pas ky ligj antikushtetues u kthye nga Gjykata Kushtetuese dhe të gjithë avokatët e pezulluar apo që iu ishin revokuar liçensat, i rimorën ato.

Dënimi i ish-zyrtareve të lartë të regjimit komunist gjatë periudhës 1991-1995 është një dimension tjetër i procesit të "dekomunistizimit shqiptar". Të gjithë u dënuan me deri në 10 vjet burg. Vështirësia për gjetjen e argumenteve bindëse ligjore e ktheu në qesharak këtë proces, që në Shqipëri njihet si procesi i "dënimit të ish-zyrtarëve të lartë të regjimit komunist" përmes "gjyqeve të kafeve". Mandej kemi Ligjin nr. 8043, datë 30 nëntor 1995, Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik, i njohur në publikun shqiptar si "ligji i gjenocidit", i cili do të përbënte tentativën e parë të lustracionit kryesisht me "natyrë revanshi politik kundër opozitës dhe veprimit opozitar". Në bazë të këtij ligji u ngrit komisioni "Mezini", që do të merrej kryesisht me pengimin e një numri të konsiderueshëm të figurave opozitare nga kandidimi në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996. Këshilli i Evropës ka kritikuar ligjet që e kufizojnë të drejtën e personave për t'u zgjedhur, përveç rasteve kur ata janë të dënuar me vendim gjykatë, dhe në mënyrë më specifike këtë ligj të miratuar nga parlamenti shqiptar. Për këtë arsye, ky ligj është amenduar tre herë, përkatësisht:

- i) me Ligjin nr.8220, datë 13.5.1997, të miratuar nga parlamenti me mazhorancë të PD-së, ii) me Ligjin nr.8232, datë 19.8.1997, të miratuar nga parlamenti me mazhorancë të PS-së, dhe iii) me Ligjin nr.8280, datë



15.1.1998, të miratuar nga parlamenti me mazhorancë të PS-së. Pas fitimit të zgjedhjeve të vitit 1997 nga PS-ja dhe aleatët e saj, do të krijohet mbi bazën e këtij ligji komisioni "Bezhani". Pas zgjedhjeve të vitit 1997, ky ligj do të vepronte vetëm mbi zyrtarë të tjerë të lartë, dhe sipas nenit 16, do të përfundonte së vepruari në vitin 2001, nen i cili parashikonte gjithashtu mbylljen e të "gjithë dokumentacionit mbi të cilin ishte kryer procesi i lustrimit deri në vitin 2025".<sup>5</sup>

Nga viti 1996 kemi për herë të parë një kornizë ligjore të një procesi potencial lustracioni, që nuk duhet kursesi të shkelte të drejtat e njeriut. Kjo erdhi përmes rezolutës nr.1096, të vitit 1996, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës "Për masat për çrrënjosjen e trashëgimisë së ish-sistemeve totalitare komuniste", deri më tej me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe me opinionin "Amicus curiae" nr. 524 , të vitit 2009, të Komisionit Evropian për Demokracinë, i njohur si Komisioni i Venecias. Kjo kornizë e qartë ligjore e vendos ligjvënësin shqiptar përpara një sërë rregullash diktuese që përcaktojnë qartazi kufijtë që nuk duhen shkelur. Respektimi i këtyre kufijve ka qenë një sfidë më tepër politike se sa ligjore, pasi ndërmarrjet për të pasur një ligj lustracioni kanë qenë më tepër nisma të politizuara qysh në start, me synim përfitim e kapitalit politik, se sa përpjekje të sinqerta për të përmbyllur një proces që duhet të kishte përfunduar ndërkohë.

Nga ana tjetër, mbetet ende fakt që kemi një kornizë ligjore të paplotësuar për dënimin e krimeve të komunizmit në mënyrë shterruese, çka do të ndihmonte në përmbylljen e kapitullit të ballafaqimit me të kaluarën, do lejonte shoqërinë të kryente një proces katharsisi, por edhe të na barazonte me praktikën më të mira që vijnë nga vendet e ish-Lindjes komuniste. Siç shprehet Besim Ndregjoni, kryetar i Unionit Mbarëkombëtar të të Internuarve dhe të Përndjekurve Politikë:

Ajo që qeveria ka bërë për hapjen e dosjeve është një demagogji. Ata thonë se i janë referuar modelit gjerman për hapjen e tyre, por modeli gjerman nuk lejon as mësuësin të japë mësim në një shkollë demokratike nëse ka qenë bashkëpunëtor i regjimit. Ligji i dosjeve tek ne nuk penalizon asnjë prokuror, hetues, gjykatës apo zyrtarë të lartë, i cili ka marrë pjesë drejtpërdrejt në kryerjen apo ekzekutimin e një krimi në atë kohë. Hapja e dosjeve nuk është problem për ne, por për brezin e ri, që ky krim të mos përsëritet më. Krimet nuk mbarojnë tek spiunimi, por fillojnë tek ai

---

5). "Lustrimi" synon goditjen e sistemit të drejtësisë..." <http://www.arkivalajmeve.com/Lustrimi-synon-goditjen-e-sistemit-te-drejtesses.158036/> 15 dhjetor 2008.

dhe përfundojnë në një sistem të tërë, që ishte kthyer në një makineri apo ideologji shfarosëse. Pa u ballafaquar historia e krimeve komuniste me drejtësinë dhe pa u dënuar ato krime, Shqipëria nuk mund të ndërtojë një demokraci”, shprehet Ndregjoni (Cuka, 2015).

## Fati i lustracionit dhe politika: Quo Vadis?

Në maj të këtij viti (2020) u prezantua në Parlamentin e Shqipërisë një projektligj “Për Përrjashtimin nga emërimi, zgjedhja në organe drejtuese dhe punësimit në funksione publike, shtetërore dhe politike të ish-funksionarëve, nëpunësve që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 e deri në 8.12.1990”,<sup>6</sup> si nismë e njëzet e një deputetëve të opozitës parlamentare. Një nga deputetët propozues argumentoi dhe arsyet e sjelljes së kësaj nisme ligjore në Kuvend përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ai theksoi *inter alia* se, “ka ardhur koha që pas 30 vitesh pas-komunizëm, nisur edhe nga dy kërkesa të njëpasnjëshme të Këshillit të Evropës për dënimet ndërkombëtare të krimeve të regjimeve totalitare komuniste, në Shqipëri të ketë një ligj që e ndan atë përfundimisht nga e kaluara komuniste”. Më tej ai nënvizoi se shqiptarët meritojnë që në organet e reja të drejtësisë, të ngritura në zbatim të Reformës në Drejtësi, të mos ketë ish-hetues, ish-prokurorë apo ish-gjykatës të kohës së komunizmit.<sup>7</sup> Duhet theksuar që nga hartuesit e projektligjit u renditën 23 funksione publike politike, prej të cilave përjashtohen ish-drejtuesit komunistë të periudhës 28.11.1944 e deri në 8.12.1990, duke nisur nga postet e presidentit, kryeministrit, deputetit, ambasadorit, të punësuarit të SHISH, etj.<sup>8</sup>

Ky projektligj, qysh në fazën e shqyrtimit në Komision, u gjykua nga relatori i mazhorancës parlamentare të ishte në papajtueshmëri të plotë me Kushtetutën, por edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe me opinionin “Amicus curiae” nr. 524 , të vitit 2009, të Komisionit Evropian për Demokracinë, i njohur si Komisioni i Venecias. Ai theksoi, ndër të tjera, se “nismëtarët nuk kanë përcaktuar në relacion nevojën dhe shkaqet e shtuara nga ato të paraqitura në vitin 2008, (ligj që është shfuqizuar); ndërkohë që projektligji nuk parashikon një mekanizëm të përshtatshëm që përcakton fajin individual; përjashton nga zgjedhja në kundërshtim të hapur me standardet ndërkombëtare sipas të cilave lustracioni nuk duhet zbatuar në funksionet e

6). “Kuvendi fut në procedurë një projektligj që e ka rrëzuar Kushtetuesja”, *Gazeta Dita*. <http://www.gazetadita.al/kuvendi-fut-ne-procedure-nje-projektligj-per-ish-funksionaret-komuniste-qe-e-ka-rreruar-kushtetuesja/> 24 Prill 2020.

7). “Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut rrëzoi në parim një projektligj dhe zhvilloi një dëgjese për raportimin e veprimtarisë vjetore të KPP për vitin 2019” <https://www.parlament.al/News/Index/10100> Postuar më, 27/05/202.

8). Ligji i ri për lustracionin/ Nisma e 20 deputetëve për të larguar nga politika funksionarët në komunizëm <https://top-channel.tv/2020/04/24/ligji-i-ri-per-lustracionin-nisma-e-20-deputeteve-per-te-larguar-nga-politika-funksionaret-ne-komunizem/> 24 Prill 2020.

zgjedhshme, përveçse kur kërkohet nga kandidatët; nuk përcaktohet një afat kohor lidhur me kohëzgjatjen e masës së lustracionit dhe së fundi kufizon të drejtën e punës dhe të drejtën e aksesit në shërbime publike”.<sup>9</sup> Pas rrëzimit nga komisioni përkatës, ky projektligj u rrëzua edhe në seancën plenare me 72 vota kundër, 30 pro dhe 6 abstenim.<sup>10</sup> Ndërkohë, rreth një muaj më vonë, mazhoranca socialiste rrëzoi në seancë plenare edhe një projektligj të një deputeti të opozitës parlamentare, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar”.<sup>11</sup>

Mbetet për momentin e paqartë nëse do të ketë një nismë të mazhorancës socialiste për të pasur një ligj të mirëfilltë të lustracionit përpara zgjedhjeve parlamentare të prillit 2021, apo do të ketë një iniciativë të re ligjore nga ana e opozitës parlamentare. Për mazhorancën socialiste edhe nga pikëpamja elektorale, nuk duket se bën shumë sens aktivizimi i një mekanizmi lustracioni në një vit elektor. Në fakt, edhe sot vlen shprehja që ka thënë qysh në 2008-ën, asokohe deputeti opozitar Pandeli Majko (aktualisht ministër i diasporës), kur shprehej se “Çfarë ne nuk arritëm në 1992, çfarë nuk arritëm në 1996, nuk do ta arrijmë në 2008-ën”. Afërmendsh akoma më e pamundur apo e dëshirueshme mund të jetë kjo në 2021-shin, që përkon dhe me zgjedhjet parlamentare. Ndërkohë, ka pak gjasa që një iniciativë e tillë të vijë prej opozitës jashtë-parlamentare, për shkak të bojkotit parlamentar, por mund të ketë një iniciativë bi-partizane me vullnet të përbashkët politik për të pasur një nismë të gjithëpranuar.

Por, praktika e deritanishme ka treguar se ka pak vullnet politik për të bashkëpunuar për iniciativa të përbashkëta ligjore që nuk sjellin kapital shtesë politik, veçanërisht përpara proceseve zgjedhore. Madje e kundërta ka ndodhur shpeshherë, kur pikërisht për të përfituar kapital politik në prag të fushatës zgjedhore të radhës, veçanërisht për zgjedhjet parlamentare, palët politike kanë inicuar projektligje me peshë simbolike, por shpeshherë të pazbatueshëm ose me mangësi ligjore, me synimin për të pasur një efekt elektor në favor të subjektit të tyre politik.

Nuk kanë munguar këtu edhe shembujt e projektligjeve që adresojnë drejtësinë transitorë në Shqipëri, dhe që, siç i përmendëm, fillojnë nga viti 1991,

9). “Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut rrëzoi në parim një projektligj dhe zhvilloi një dëgjese për raportimin e veprimtarisë vjetore të KPP për vitin 2019” <https://www.parlament.al/News/Index/10100> Postuar më, 27/05/202.

10). “Kuvendi mbledhet në seancë plenare; miratohen tre projektrezoluta, tre akte normative, katër projektligjet e paketës penitenciare dhe një projektvendim. Votohen kundër një projektligj dhe dy dekrete të Presidentit”. <http://parlament.al/News/Index/10194> Postuar më, 25/06/2020.

11). Kuvendi në seancë plenare, miratohen dy projektligje, rrëzohet dekreti presidencial dhe votohen kundër dy nisma ligjore deputetësh <https://www.parlament.al/News/Index/10260>, postuar më 16/07/2020.

për të vijuar më pas me vitet 1992, 1993, 1995, 1998, e me radhë. Është vështirë të demonstrosh një lidhje shkakësore të fortë mes kalimit të këtyre ligjeve dhe cikleve zgjedhore, por një lidhje korreccionale del qartazi në pah po të kemi parasysh mekanizmat e drejtësisë transitore si falja, përmendoret, komisionet e së vërtetës apo lustracioni, të miratuara dhe zbatuara shpesh me vullnet politik të njëanshëm, dhe që i adresoheshin një pale të qartë votuesish në dëm të palës tjetër.

## **Analiza e të dhënave nga sondazhi dhe intervistat**

Të dhënat e nxjerra nga sondazhi përfshijnë 32 pyetësorë të individualizuar që rrokin grupet kryesorë të interesit. Ndërkohë, për studentët u bë një fokus grup i strukturuar, ku ndër gjetjet kryesore ishte informimi i pakët që ata kishin për lustracionin, duke nisur dhe nga vetë termi, dhe vijuar mandej me historikun dhe aplikimin e tij në rastin shqiptar. Kësisoj, fokus grupi përveçse ishte një mënyrë empirike vëzhgimi e faktit sa e njihnin dhe sa njohuri kishin studentët për procesin, ishte edhe një mjet për t'i informuar ata duke parë shkallën e ulët të informacionit, por edhe interesit për këtë temë. Kjo vjen pasi edhe kurrikulat parauniversitare dhe universitare, madje dhe pasuniversitare, janë vërtet të vakëta në trajtimin e tematikës së drejtësisë transitore në përgjithësi, dhe lustracionit në veçanti.

Përsa i përket sondazheve, ato përfshinë historianë dhe studiues të politikës dhe sociologjisë, diplomatë karriere dhe drejtues institucionesh publike, gazetarë dhe publicistë që farkëtojnë mendim publik, por edhe ish-të persekutuar politikë. Ideja ishte të krijohej një bazë të dhënash plotësuese për ato të nxjerra nga intervistat, ndonëse kategoritë janë pak a shumë të ngjashme. Edhe vetë përgjigjet përputhen në pjesën më të madhe si në lidhje me informacionin që kanë për procesin, ashtu dhe në lidhje me kritikën apo me mënyrat se si mendojnë se ky proces mund të ishte kryer më mirë. Gjithashtu, edhe në rekomandimet që japin duke u nisur nga situata aktuale.

Për sa i përket, për shembull, pyetjes për mekanizmat më të efektshëm për trajtimin e drejtësisë transitore, ndonëse të gjitha kategoritë prekeshin, shumica ishin të ndarë mes ndëshkimit me ligj nga njëra anë, dhe faljes dhe harrimit nga ana tjetër. Ndërsa pyetjes se cilat ishin mekanizmat më të zakonshëm të ndërmarrë për të korrigjuar krimet e komunizmit, shumica dërrmuese ishin të mendimit se mekanizmi kyç ishte shpërblimet. Vetëm pak prej tyre shpreheshin për lustracionet apo komisionet e së vërtetës, dhe akoma më pak për faljet, ndërsa nuk pati ndonjë që tha memorialet apo bustet. Shumica absolute gjithashtu mendonin se Shqipëria nuk e ka trajtuar të kaluarën komuniste në mënyrën e duhur deri tani, ndjekur me disa që pohonin se e ka trajtuar disi dhe asnjë që mendonte se e ka trajtuar plotësisht në mënyrë shteruese.

Shumica dërrmuese e të pyeturve gjithashtu mendonin se vitet 1990-të ishin ato me më shumë rezultat për sa i përket përparimit në legjislacionin për lustracionin, dhe jo vitet 2000, për shembull, kur u pa dhe një ligj lustracioni i kaluar

në Parlament dhe i rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese, apo vitet aktuale ku kemi ngritjen e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, apo siç njihet rëndom Autoriteti i Dosjeve. Ndoshta kjo lidhet me komisionet Mezini dhe Bezhani, me gjyqet për ish-nomeklaturën e regjimit të kaluar, apo me njëfarë lustrimi të sistemit të drejtësisë, megjithë difektet që ai pati si proces. Apo edhe reforma në ushtri etj.

Shumica e të intervistuarëve mendon se nuk ka ndikim të madh të reformave zgjedhore në funksion të lustracionit ose të paktën nuk kanë qenë efektive. Siç shprehej në mënyrë plotësuese një prej të pyeturëve, edhe nëse ka patur tentativa “nuk kanë qenë efektive. Edhe pse mund të ketë pasur në letër diçka të shkruar, ato kurrë nuk janë zbatuar”. Ndërkohë, pak të tjerë që janë shprehur që kanë pasur efekt, janë shprehur për ekstremet, pra vitin 1992, ose vitet 2013 dhe 2017, por jo vitet e ndërmjetëm. Shumica, gjithashtu, janë të ndarë mes faktit që lustracioni nuk ka qenë aspak i suksesshëm me të qënurit disi i suksesshëm, por ata që mendojnë se ka qenë plotësisht i pasuksesshëm janë përsëri në shumicë absolute. Gjithashtu, shumica mendon se Shqipëria ka ndjekur praktika më të këqija të lustracionit në krahasim me vendet e tjera ish-komuniste.

Nga ana tjetër, në intervistat e kryera me ish-politikanë dhe politikanë aktualë, drejtorë të institucioneve të rëndësishme shtetërore dhe qeveritarë, gazetarë dhe studiues që kanë shkruar për lustracionin në shtypin shqiptar dhe aktivistët e shoqërisë civile në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe ish-të përndjekurit politikë, arrita të mbledh disa opinione dhe të dhëna me mjaft vlerë që çojnë gjithashtu në disa prej gjetjeve kryesore që ky raport ofron.

Ndër nga gjetjet kryesore ishte nevoja që Shqipëria ka pasur qysh në vitet e para të tranzicionit demokratik për një ligj të plotë dhe efektiv lustracioni. Nëse kjo do të ishte bërë sipas shembullit më të mirë të vendeve të ish-Evropës Lindore, si Gjermania Lindore apo Çekosllovakia, atëherë Shqipëria do të kishte mundur të dekomunistizohej, të kryhej një proces i nevojshëm katharsisi shoqëror, dhe të mund të krijonte një shtet të së drejtës. Pjesa më e madhe e të intervistuarëve gjithashtu ndajnë mendimin se nuk është vonë për t’u ndërmarrë një proces i tillë, qoftë me anë të miratimit të një ligji të ri që do të respektonte dhe të drejtat e njeriut, afatet kohore dhe kufizimet e tjera sipas vendimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Gykatës së Strasburgut ose Komisionit të Venecias, që janë shprehur me shkrim në lidhje me standardet që duhet të plotësojë një ligj lustracioni, dhe jo vetëm për rastin shqiptar, por edhe me referenca të tjera nga vendet e ish-Lindjes komuniste. Një pjesë e të intervistuarëve i kushtoi vëmendje më të madhe çfarë është bërë keq ose nuk është bërë mjaftueshëm në të kaluarën, ndërsa të tjerë ishin më të

fokusuar në stadin aktual ose çfarë duhet bërë në të ardhmen e afërt. Në mënyrë më të strukturuar, duke cituar pjesërisht vetë të intervistuarit në mënyrë të përmbledhur, më poshtë janë disa prej përgjigjeve të tyre, duke i marrë me radhë sipas renditjes alfabetike:

Afrim Krasniqi i Institutit për Studime Politike thotë, për shembull, që procesi i lustracionit ka qenë një eksperiment të vazhdueshëm; në fakt kanë qenë më tepër disa procese të mbivendosura njëra-tjetrës, dhe shpesh me masa që varionin nga super të buta deri te ato drakoniane. Ai shton se, "duke qenë i vonuar, i mbivendosur, i motivuar për qëllime politike në prag të fushatave elektorale dhe i bazuar në akte politike, jo në akte ligjore dhe administrative të qëndrueshme, ndaj nuk mendoj se ka qenë i suksesshëm". Ndërsa, përsa i përket nevojës për një ligj lustracioni në momentin ku jemi, ai thotë ndër të tjera se "lustracioni ka qenë 100% i nevojshëm në dekadën e parë të viteve '90, me vonë u bë moralisht i nevojshëm, dhe tani është simbolikisht i nevojshëm, pasi moshat 45-60 vjeçare të vitit '90, nëse ende jetojnë, janë në pension dhe nuk pretendojnë me role publike. Gjithsesi, pa një hapje e zbardhje të dosjeve sekrete do jetë e vështirë të ketë trajtim e ndarje me drejtësi me periudhën komuniste, mitet do vijojnë të dominojnë të vërtetat, elitat e emëruara do vijojnë të jenë elita edhe të tranzicionit, dhe sistemi komunist do të vijojë të trajtohet si 'faj i sistemit', jo i njerëzve që e drejtuan atë ose përfituan prej tij".

Aleksandër Meksi, ish-kryeministri i parë i Shqipërisë pluraliste nga viti 1992 deri në 1997, njëkohësisht dhe një nga iniciatorët e hapjes së dosjeve dhe procesit të lustracionit, thotë ndër të tjera: "[e]dhe pse është një çështje mjaft e debatueshme dhe gjithnjë nën mbrojtjen haptas nga e majta, madje dhe nga përkrahësit e huaj të të njëjtit drejtim politik, mendimi im është se lustracioni duhej, duhet dhe përmbyllja e tij me një ligj që konsideron kohën në të cilën do miratohet e zbatohet, do të ishte tejet i dobishëm për përfundimin e tranzicionit, duke u ndarë nga e kaluara komuniste e një regjimi kriminal. Unë personalisht, si promovuesi dhe bashkëhartuesi i Ligjit që u miratua në vitin 1995, ashtu dhe si pjesë e grupit të përmirësimit e përditësimit në vitin 2014 të projektligjit paraqitur për hapjen e dosjeve nga deputetët Sh. Idrizi e M. Doda, mbi bazën edhe të përvojës së viteve të fundit në zbatim të Ligjit "Për Hapjen e Dosjeve", shprehem se me pak punë mund të hartohet një ligj i drejtë që siguron lustracionin, çka është dhe gurë prove për dënimin e së kaluarës komuniste". Ai shton se, nga ana tjetër, duhet të merret patjetër në konsideratë respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, e në të njëjtën kohë garanci për mospërdorimin e metodave të së kaluarës dhe nga ata që i zbatuan ndaj të pafajshmëve. Ai shton se, "kuptoj vështirësinë për këtë, sepse socialistët shqiptarë ende nuk e kanë dënuar realisht komunizmin enverian të



PPSH-së, dhe as u kanë kërkuar ndjesë viktimave dhe shqiptarëve për atë diktaturë kriminale. Pa një proces lustracioni nga postet drejtuese të shtetit shqiptar të atyre që janë përlyer me krime gjatë diktaturës, që kanë hartuar e zbatuar platformat sekrete të Sigurimit të Shtetit, që janë marrë me hetimin e dënimit për *'krime të opinionit e mendimeve'*, dhe me dëshmi të rrema, është e kotë të flitet në Shqipëri për demokraci reale”.

Blerina Gjoka, Drejtore e Fondacionit Kujto - Arkiva Online e Viktimave dhe Krimeve të Komunizmit, thekson se nuk janë miratuar ligjet e duhura për të trajtuar të kaluarën, ose janë bërë antikushtetuese, si rasti i Ligjit të Lustracionit të vitit 2008 që u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese, apo Ligji për Hapjen e Dosjeve me të cilin u ngrit Autoriteti i posaçëm për këtë çështje, një ligj që përsëri ka nevojë për përmirësime, pasi krijon shumë pengesa për hapjen reale të dosjeve të sigurimit. Gjithashtu, ajo e vë theksin te fakti që lustracioni si proces rrezikon gjithmonë të përdoret për interesa politike për të luftuar kundërshtarët, dhe ka kritika ndaj mënyrës se si u zbatua lustracioni gjatë viteve 1992-1997 për të sulmuar kundërshtarët politikë. Por, znj. Gjoka thekson se, “gjithsesi, besoj se më mirë me një ligj lustracioni të keq, se sa pa një ligj të tillë, që u jep kështu mundësi ish-funksionarëve politikë dhe drejtuesve të sigurimit të shtetit të vijojnë të ruajnë pozitat e tyre në politikë apo administratë. Kjo është një fyerje për mijëra viktima të komunizmit që kërkojnë të paktën një drejtësi morale”.

Çelo Hoxha, Drejtori Ekzekutiv i ISKK-së, thekson ndër të tjera se ligji i lustracionit ka patur ndikim në zgjedhjet e vitit 1996. Ai vë në pah se “njerëzit, që ai ligj përjashtoi nga kandidimi atë vit, pak muaj më vonë u bënë shumë aktivë gjatë protestave të dhunshme të vitit 1997, dhe shumë shpejt u kthyen në politikë, përmes zgjedhjeve që u imponuan me dhunë”. Theksi i z. Hoxha këtu është se mungesa e një procesi lustrimi bëri të mundur që, të njëjtët persona të cilëve iu duhej ndaluar me ligj kandidimi politik ose shërbimi në nivele të larta të administratës publike, arritën të ruanin status quo-n, dhe madje të ktheheshin në protagonistë të zhvillimeve politike në vitet e mëvonshme.

Ndërsa Dorian Koçi, Drejtori i Muzeut Kombëtar, e vë theksin te fakti që ligjet kanë dështuar dhe janë paragjykuar si të njëanshëm. Ai thotë se “kam parasysh ligjet e vitit 1995 dhe vitit 2008. Autoriteti për Informimin për Dosjet e Sigurimit të Shtetit u krijua veçse në vitin 2016, pra 25 vjet pas ndryshimeve demokratike dhe sigurisht koha e pakët në dispozicion nuk ka mjaftuar për të përmbushur një proces që duhet të kishte filluar që në vitin 1991”. Gjithashtu, ai vë në dukje se “lustracioni është i dobishëm dhe në një masë të madhe i mundshëm. Në të njëjtën kohë ai vepron si një masë mbrojtëse e morale ndaj abuzimeve të së shkuarës”.

Për studiuesin Erald Kapri kanë munguar garancitë për një proces të drejtë lustracioni. Ai thekson se, "madje mund të themi që çdo proces i nisur ka qenë i pasinqertë. Qoftë ai i 1995-s, qoftë ai i 1998-s, qoftë ai i panisuri në 2008". Për të, kryesor është fakti që nuk është punuar me të kaluarën historike. Ai shton se, "shqiptarët nuk janë shumë koshientë me çfarë ndodhi në diktaturë. Sot nuk ka ende një ditë që të nderohen mijëra viktimat. Imagjino të tjerat. Edhe procesi i kompensimit të viktimave ka qenë i pamjaftueshëm dhe i ngadaltë. Nuk pati një proces real rehabilitimi për ta".

Për Kryetarin e Partisë Republikane Fatmir Mediu, e majta ka qenë gjithmonë kundër një ligji të plotë të lustracionit, dhe padyshim në çdo moment është përpjekur në mënyrë ligjore dhe joligjore të mbrojë të gjitha figurat që preken nga ligji i lustracionit, duke i përdorur si militantë besnikë politikë, fatkeqësisht në institucione të depolitizuara. Ai mendon "që një komb pa kujtesë historike është një komb që vështirë ngrihet mbi vlera. Mosdënimi i së keqes, të paktën moralisht nga gjithë shoqëria, krijon probleme të mëdha në organizimin dhe funksionimin politiko-institucional të vendit".

Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në vitet 1944-1991, thekson se nga viti 1990 deri në vitin 2015, iniciativat ligjore në Shqipëri i dhanë përparësi lustracionit. Asnjë nga këto përpjekje nuk pati sukses, duke rënë pre e sfidave ligjore (kushtetuese) dhe politike. Ajo që e dallon ligjin 45/2015 për Autoritetin dhe përgjegjësitë që përcakton, nga përpjekjet e mëparshme është ndarja e çështjes së aksesit dhe transparencës nga ajo e lustracionit. Gjithashtu, ajo vë në dukje alternativat e mëposhtme:

1. Fillimin e procesit paraprak të verifikimit të pastërtisë së figurës së kandidaturave për deputet apo kryetar bashkie, ku së bashku me dokumentacionin e regjistrimit të partive politike në zgjedhje, të sillen dhe kandidaturat e mundshme për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie (jo me vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve), së bashku me formularët e aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t'u verifikuar për pastërtinë e figurës.
2. Fillimin e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurave të kandidaturave për deputet apo kryetar bashkie, në afatin kohor të paraqitjes së listës shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore, 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ku subjektet politike duhet të sjellin edhe formularët e aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t'u verifikuar për pastërtinë e figurës.

3. Verifikimi i pastërtisë së figurës së kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetëdeklarojë (varianti polak, ku nëse vetëdeklarimi është i rremë, çështja dërgohet në gjykatën kompetente), nëse është në kushtet e parashikimeve të nenit 30 të Ligjit 45/2015, variant ky nëse vërehet ekzistenca e kushteve ka penalitetet e duhura.

Gjergj Erebara, gazetar dhe analist i BIRN Albania, thekson se ndryshe nga shumë vende të tjera të Evropës Lindore, në Shqipëri ka pasur shumë pak ndërhyrje ligjore në drejtim të lustrimit. Në vitin 1995 ka pasur një proces disi më serioz, por jo tërësisht të efektshëm në ndalimin e personave me të shkuar nga Sigurimi i Shtetit në mbajtjen e posteve të larta publike, politike apo të emëruara. Në vitet 1997-1999, një numër vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e së cilës në shumicë vijonin të ishin ata që ishin emëruar nga qeveria e fundit komuniste, rrëzoi si antikushtetuese pjesën më të madhe të ligjit të lustracionit të vitit 1995, duke legjitimuar mbajtjen e pushtetit nga të njëjtët njerëz që nga vitet 1980 e më pas. Kjo është veçanërisht e dallueshme në strukturat e sistemit gjyqësor, ku klasa e gjyqtarëve dhe prokurorëve politikë që kanë nisur karrierën në fund të viteve '80, vijon të ketë efektivisht pushtetin në institucionet e gjyqësorit edhe sot. Ai gjithashtu mendon se sektori i shoqërisë civile është më i mirëpozicionuar për ta trajtuar këtë problem, në kushtet e institucioneve të dobëta ose të mbyllura ndaj ndryshimeve. Ndërhyrja institucionale, si në rastin e grupit të punës për gjetjen e eshtrave të të zhdukurve të kohës së komunizmit, rezultoi një provë e dështuar për shkak të refuzimit ekstraligjor të shumicës dërrmuese të institucioneve për t'u angazhuar në procesin e hulumtimit për gjetjen e varreve.

Gazetari dhe studiuesi Kastriot Dervishi, që ka shkruar gjerësisht për lustracionin, vë në pah se Shqipëria ka pasur një proces të pjesshëm lustracioni, që funksionoi në një kohë të shkurtër vetëm në vitin 1996. Ligji nr.8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", u vu në zbatim në zgjedhjet e 26 majit 1996 (për Kuvendin) dhe 20 tetorit 1996 (vendore, por kontrolli vetëm i kandidatëve për kryetar bashkish). Nuk pati një proces në kuptimin e plotë të ligjit në fjalë, sepse nuk veproi mbi subjektet që ligji prekte si në sistemin gjyqësor, administratë, etj. Me ndryshimet që iu bënë në vitin 1997, ligji u rruadh së tepërmi, sepse u drejtua vetëm kundër ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit (për më tepër edhe ndaj këtyre me kufizim kohor) dhe kundër oficerëve madhorë të tij. Por edhe këta të fundit, me dispozitën përjashtuese, i emëronte kryeministri (siç i emëroi). Komisioni i drejtuar nga Hajri Mezini në vitet 1996-1997, pra, shqyrtoi vetëm kandidatët për deputetë

dhe kandidatët për kryetarë bashkish. Komisioni që më pas u drejtua nga Nafiz Bezhani në vitet 1997-2001, nuk shqyrtoi asnjë kandidat për deputet apo kryetar bashkish, por vetëm disa nivele të ulëta në forcat e armatosura dhe në diplomaci. Realisht veproi vetëm kundër bashkëpunëtorëve të Sigurimit. Ndër mekanizmat që ai propozon janë: vendosja në Kodin Zgjedhor që të afishohet fakti që kandidati për deputet ka qenë pjesë e strukturave kriminale apo bashkëpunëtor i Sigurimit, si dhe mund të mos njihet me Vendim të Këshillit të Ministrave diploma e Shkollës së Lartë të MPB-së, profili Sigurim. Si efekt i kësaj të dytës, të mos njiheshin si vjetërsi pune vitet e rrjedhura nga koha e Sigurimit të Shtetit, etj.

Nebil Çika, Kryetari i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë thekson prerazi se nuk ka pasur një proces të mirëfilltë lustracioni. Ai shton se "ka patur përpjekje sporadike dhe shumë vullnet politik për të penguar, devijuar e sabotuar çdo iniciativë ligjore për këtë qëllim. Megjithëse në Shqipëri ekzistojnë ligje e institucione që merren me të kaluarën komuniste, ato nuk shkojnë tek lustracioni dhe shkelen ose anashkalohen nga institucionet që duhet t'i zbatojnë. Korniza ligjore është tërësisht e pamjaftueshme, dhe po t'i shtosh moszbatimin e tyre bëhen pothuaj të paqena. Ligjet e deritanishme janë shkelur e manipuluar hapur për përfitime politike". Ligji parashikon kufizime për autorë të krimeve të komunizmit në të gjitha nivelet e pushtetit, parlament, qeveri, administratë, institucionet e sigurisë, drejtësi, etj. Por, pikërisht ajo pjesë e ligjit që mund të konsiderohet si një lloj lustracioni, nuk zbatohet. Z. Çika vijon duke thënë se, "aktualisht sistemi i drejtësisë është në veting, dhe ligji i vetingut i ndalon autorët e krimeve të komunizmit të jenë pjesë e institucioneve të reja të drejtësisë. Deri tani institucionet e vetingut nuk e kanë zbatuar këtë pjesë të ligjit, duke bërë që në drejtësi të rrimërohen sërish shumë autorë të krimeve të komunizmit, gjyqtarë, prokurorë, hetues, anëtarë të Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtorë të tij të kalojnë 'filtrat' duke u bërë drejtues të drejtësisë së re. Vetingu jo vetëm që nuk e ka pastruar drejtësinë nga autorë të krimeve të komunizmit, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, por ka mundësuar kapjen e drejtësisë prej tyre. E njëjta gjë mund të thuhet për institucionet e sigurisë, policinë, shërbimin sekret, SPAK-un etj".

Simon Mirakaj, ish i persekutuar politik dhe anëtar i Bordit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në vitet 1944-1991, thotë se "ligji i lustracionit tek ne nuk ka ekzistuar, nuk është vënë në zbatim sepse nuk ka ekzistuar, por është vënë në zbatim sipas preferencave politike. Ne jemi dëshmitarë se mjaft nga ish-ligjvënësit apo ligjzbatuesit e periudhës së diktaturës mbërritën në majat më të larta të drejtësisë e të administratës shtetërore në demokraci. Ne kemi pasur prokurorë që kanë dhënë dënime politike në Prokurorinë e Përgjithshme,

në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, etj, pikërisht se nuk patëm një ligj, por ia lamë preferencave politike, ky është i yni dhe ky duhet larguar se nuk është i yni". Gjithashtu, sipas mendimit të tij "klasa politike nuk ka qenë e interesuar për të hartuar një ligj lustracioni, kjo edhe me arsyetimin se nuk na mbështet Evropa me pretendimin se shkelën të drejtat e njeriut. Kjo duket i shkoi dhe për shtat klasës politike, pra u pajtua me situatën". Ai thekson edhe njëherë se "spektri politik, sidomos e majta, u bë pengesë dhe nuk i mbështeti iniciativat e marra nga spektri politik i djathtë përse i përket ligjit të lustracionit. Pati iniciativa, si në 1995-n kur u hartua një ligj për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit i quajtur 'ligji Mezini', e më vonë në 2001 ligji i quajtur 'Bezhani', por nuk qenë të suksesshëm se u morën vetëm me pastërtinë e figurës së deputetit, nuk ishin ligje lustracioni".

Uran Kostreci, ish i dënuar politik, thekson se "duhet të vihet drejtësi për krimet e komunizmit dhe ata që kanë ndihmuar në këtë proces si ish-bashkëpunorët e Sigurimit, përmes një procesi që do të mundësojë njohjen e së kaluarës totalitare, demaskimin e krimeve të komunizmit etj, dhe moslejimin e tyre në funksione të larta publike dhe në gjyqësor". Gjithashtu, z. Kostreci bën thirrje që të ndiqen shembujt e suksesshëm të ish-Evropës Lindore, duke veçuar rastet e Gjermanisë Lindore, Çekisë dhe Rumanisë, ku reformat e tyre për lustracionin bënë të mundur që këto vende ta linin pas të kaluarën dhe të demokratizoheshin më shpejt.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Ky hulumtim u mundua të përfshinte krahasimin e mënyrës se si është kryer lustracioni si elementi më ilustrues i drejtësisë transitore në ish-Evropën Lindore, duke u ndalur sidomos te rastet e Rumanisë dhe Ukrainës që kanë disa përbashkësi, por dhe të veçanta thelbësore me rastin shqiptar. Këto dy raste, që kanë zhvilluar një proces lustracioni në dy kohë të ndryshme, kanë adoptuar praktika kushtetuese që variojnë, kanë pasur debate politike dhe publike që kanë shoqëruar ndryshimet ligjore, dhe kanë pasur mënyra të ndryshme zbatimi, që është shoqëruar me jo pak debat publik dhe politik. Këto vende, që janë detajuar në këtë studim, por edhe vendet e tjera të ish-Evropës Lindore që janë cekur duke përmendur arritjet e tyre kryesore në fushën e lustrimit, janë shembuj nga të cilat Shqipëria mund të vjelë informacionin dhe praktikën më të mira për t'i përshtatur në një kuadër të ri ligjor që do të trajtonte lustracionin.

Gjithashtu, raporti detajoi historikun e përpjekjeve ligjore dhe vendimet e gjykatave, hendeqeve institucionale dhe përplasjeve politike që kanë shoqëruar këto tre dekada përpjekje për të pasur një ligj lustracioni të cilin disa, përfshirë të intervistuar dhe konsultuar për këtë studim, e quajnë ose betejë e humbur, ose shans të munguar. Madje, disa shkojnë aq larg sa ta quajnë kapitull të mbyllur që nuk vlen të rihapet në këto momente.

Ndërkohë, të tjerë mendojnë se pa një proces të mirëfilltë lustracioni, sado të vonuar në kohë, Shqipëria nuk mund të arrijë katarsisin shoqëror, të mbyllë plagët e së shkuarës, të tejkalojë antagonizmin politik ku shpesh e kaluara e kundërshtarëve përdoret për t'i shantazhuar ata, si dhe të konsolidojë shtetin e së drejtës. Nëse kjo arrihet, atëherë vetvetiu do të sjellë edhe rritjen e cilësisë së përfaqësimit politik duke çuar dhe në konsolidimin demokratik.

Për shembull, diskutimet e fundit për Kodin Zgjedhor, që përfshinë edhe ndryshimet kushtetuese, mund të kishin qenë njëherazi përpjekje për të 'lustruar' listat e kandidatëve nga ata që kanë qenë punonjës apo bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit, dhe ka (ende) evidenca që kanë bashkëpunuar në krime kundër individëve apo shoqërisë. Por, kjo mund të ishte e mundur nëse do të kishim një dakordësi të re për një ligj të ri të lustracionit, i cili do të mbante parasysht edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 2010-ës, edhe mendimet e Komisionit të Venecias, dhe të ishte në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut.

Rastet e suksesshme të hershme në kohë që tentuan dhe përfunduan me saktësi kirurgjikale dhe shpejtësi të lavdërueshme të ish-Gjermanisë Lindore apo Çekosllovakisë, apo ato më të vonshme por që e kryen në mënyrë të pjesshme apo të plotë procesin e lustracionit si vendet e tjera të Vishegradit apo Rumania, apo edhe aty ku ende vijon debati si rasti i Ukrainës, janë shembuj domethënës nga të cilat Shqipëria mund të informohet dhe të mund të aplikojë praktikat më të mira. Kjo mund të arrihet duke mësuar nga përvojat, duke aplikuar formulat e suksesshme dhe duke kërkuar ekspertizën më të mirë ndërkombëtare. Një ndihmë të vyer në këtë drejtim mund të japin dhe organizatat ndërkombëtare që kanë prezencë në Shqipëri dhe jo vetëm.

Në bazë të përfundimeve të nxjerra nga të dhënat e gjeneruara nga ky studim, mendoj se Shqipëria ka shumëçka për të mësuar, si nga përvoja e saj jo fort e suksesshme në lidhje me përpjekjet për lustrim, ashtu edhe nga përvojat më të mira të ish-vendeve komuniste në Europën Lindore, qofshin ato që e kanë kryer herët këtë proces apo ato që e kanë filluar në një kohë të mëvonshme. Më poshtë po rendisim disa rekomandime modeste që mund të merren parasysh nga ligjvënësit shqiptarë:

Së pari, duke i'u referuar dhe rastit rumun të shqyrtuar dhe në këtë studim, do të ishte e këshillueshme të nxitej pjesmarrja e shoqërisë civile ose të merreshin parasysh rekomandimet e dhëna prej tyre në vite. Këtu flasim për organizata jo-fitimprurëse, aktivistë të të drejtave të njeriut, ish të persekutuar, por edhe akademikë dhe studjues që janë marrë gjegjësisht me çështjen e drejtësisë transitore në përgjithësi dhe lustracionin në veçanti. Kontributi i tyre do të ishte i vyer në konsultimin e çfarëdolloj legjislacioni ekzistues apo të ardhshëm apo kuadri tjetër institucional.

Një rekomandim tjetër, siç doli dhe nga fokus grupi i zhvilluar për qëllim të këtij studimi, mund të jetë që mbi nevojën për të përfshirë më shumë të rinjtë në diskutimet dhe proceset e lustracionit, nevojën për kurrikula ose programe në nivelin universitar që kanë të bëjnë me lustracionin dhe njohjen e së kaluarës komuniste në Shqipëri në përgjithësi.

Së treti, nevoja imediate, pa humbur kohë për një ligj të ri të lustracionit. Pavarësisht kohës së humbur, tre dekadave të kaluara nga përmbysja e komunizmit, ekziston ende mundësia për të rifituar shanset e humbura.

Së katërti, në lidhje me hapat e mëtejshme që ndërkombëtarët mund të asistojnë në lidhje me procesin ende të paezauruar plotësisht të lustracionit në Shqipëri, do të rekomandoja zhvillimin e një konference kombëtare ku të dilet me disa rekomandime specifike që të mundësojnë një paketë ligjore për lustracionin.

Kjo është e domosdoshme dhe duhet bërë pa humbur kohë që të kemi më në fund një kuadër ligjor që do të adresonte në mënyrë përfundimtare përballjen me të shkuarën, lustrimin e administratës publike nga ish-punonjës apo bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit dhe konsolidonte shtetin e së drejtës. Për më tepër do të forconte legjitimitetin e institucioneve dhe forconte demokracinë duke e pastruar njëherazi politikën nga shantazhet politike në lidhje me të kaluarën e kundështarëve politikë.

Një bonus i shtuar do të ishte futja e Shqipërisë në hartën e vendeve ish-komuniste që kanë kryer procesin e lustracionit dhe megjithë vonesën e pajustificuar, ana pozitive është që Shqipëria ka fatin të mësojë nga përvoja më e mirë e vendeve që e kanë kryer këtë proces më herët ose me standartet më të larta.



## Referencat

Abdurrahmani, Bledar. (2018), "Transitional justice in Albania: the lustration reform and information on communism files," *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, Vol. 5, no. 3.

Acemoglu, D. (2014), "Does Democracy Boost Economic Growth?" *World Economic Forum*. Almond, G. & Sydney Verba. (1963), *The Civic Culture: Political Attitudes and Democracy in Five Nations*. Princeton University Press.

Amstutz, M. R. (2006), "Restorative Justice, Political Forgiveness and the Possibility of Political Reconciliation," in *The Politics of Past Evils: Religion, Reconciliation, and the Dilemmas of Transitional Justice*, ed. Daniel Philpott. Notre Dame: University of Notre Dame Press.

Aoláin, F. N. & Colm Campbell. (2005), "The Paradox of Transition in Conflicted Democracies," *Human Rights Quarterly* 27. 1. 174.

Arkipov, I. (2019), "Russian Support for Stalin Surges to Record High, Poll Says" Bloomberg, April 16. Downloaded from: <https://www.bloomberg.com/news/articles/2019-04-16/russian-support-for-soviet-tyrant-stalin-hits-record-poll-shows>

Aukerman, M. J. (2002), "Extraordinary Evil, Ordinary Crime: A Framework for Understanding Transitional Justice," *Harvard Human Rights Journal*, 29-98.

Austin, R. C. and Jonathan Ellison. (2008), "Post-Communist Transitional Justice in Albania." *East European Politics and Societies*, Vol. 22, No. 2, pages 373-401.

Berisha, S. (2018), "Pse ishim bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës." *Rilindja Demokratike*. Downloaded from: <http://www.rd.al/2018/02/berisha-pse-ishim-bashkefajtores-dhe-bashkevuajtes/>

Beshiri, Dh. (1998), Gjyqi i kafeve: procesi penal kundër të vesë së Enver Hoxhës. Tirane: Shtëpia Botuese "Iliria".

Blewitt, G. T. (2008), "The Importance of a Retributive Approach to Justice," in *The Legacy of Nuremberg: Civilizing Influence or Institutionalized Vengeance?* ed. David A. Blumenthal and Timothy L.H. McCormack. Leiden: Martinus Nijhoff Publishers.

Bobrinsky, Nikolai. 2015. "Lustration and Guilt: Evolution of the Venice Commission's approach." *Verfassungsblog on Matters Constitutional*. Downloaded from: <https://verfassungsblog.de/lustration-and-guilt-evolution-of-the-venice-commissions-approach/> 11 Korrik.

Borer, A. T. ed. (2006), *Telling the Truths: Truth-telling and Peace Building in Post- Conflict Societies*. Notre Dame: University of Notre Dame Press.

Brahm, E. (2007), "Uncovering the Truth: Examining Truth Commission Success and Impact." *International Studies Association*. Published by Blackwell Publishing.

Brahm, E. (Forthcoming 2020), *Truth and Consequences: The Impact of Truth Commissions in Transitional Societies*.

Brown, A. (1999), "Russia and Democratization," *Problems of Post-Communism*, 46/5, pp. 3-13.

Craciun, C. (2017), *Romania's Second Democratic Transition*. <https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/13080.pdf>

Creswell, John W. *Qualitative Inquiry and Research Design* (Thousand Oaks: Sage Publications, 2007).

Cuka, Fatjon. (2015) Hapja e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri, një proces pa konsensus në tranzicion. Anadolu Agency. Shih linkun: <https://www.aa.com.tr/sq/politik%C3%AB/hapja-e-dosjeve-t%C3%AB-ish-sigurimit-t%C3%AB-shtetit-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-nj%C3%AB-proces-pa-konsensus-n%C3%AB-tranzicion/51461#> 2 Maj.

Dahl, R. A. (1971), *Polyarchy: Participation and Opposition*. New Haven: Yale University Press.

Diamond, L. (1999), *Developing Democracy: Toward Consolidation*. John Hopkins University Press.

Drumbl, M. (2007), *Atrocity, Punishment, and International Law*. New York: Cambridge University Press.

Durovic, G. & Blazenka Stojanović. (2016), "The optimization of Public Administration in the Western Balkans Region: Comparative Study with Baseline Analysis." *Regional School of Public Administration*. Montenegro: ReSPA.

Guo, S. & Stradiotto, G. (2014), *Democratic Transitions: Modes and Outcomes*. Routledge. DOI: 10.13140/2.1.3550.7845

Hayner, P. (2002), *Unspeakable Truths: Facing the Challenges of Truth Commissions*. London: Routledge.

Ion Iliescu: Romania's ex-leader charged with crimes against humanity. 8 April 2019. Downloaded from: <https://www.bbc.com/news/world-europe-47858664>

Kajsiu, B. (2016), "Polarization without radicalization: political radicalism in Albania in a comparative perspective" *Journal of Contemporary European Studies*, 24(2): 280-299.

Kalemaj, I. (2019), "Transitional Justice and Democratic Consolidation in post-communist Eastern Europe: Romania and Albania" *TRANSITIONAL JUSTICE IN ALBANIA: A Compilation of Papers by Young Albanian Researches*, pp. 54-76. Published by OSCE Presence in Albania and Konrad Adenauer Stiftung.

Kalemaj, I. (2016), "Albania's democracy challenges: External stimuli and internal factors at play", *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, Vol. 5, No. 3, Sept. 30.

Kalemaj, I. (2014), *Contested Borders: Territorialization of National Identity and Shifts of "Imagined Geographies" in Albania*. Peter Lang Ltd. Oxford 2014.

Kayser -Whande, U. & Stephanie Schell-Faucon. 2008. "Transitional Justice and Civilian Conflict Transformation." *CCS Working Papers*. No. 10.

Kritz, N. (2009), "Policy Implications of Empirical Research on Transitional Justice," in Hugo Van der Merwe, Victoria Baxter, and Audrey Chapman, eds. *Assessing the Impact of Transitional Justice*. Washington, D.C.: U.S. Institute of Peace.

"Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut rrëzoi në parim një projektligj dhe zhvilloi një dëgjese për raportimin e veprimtarisë vjetore të KPP për vitin 2019" <https://www.parlament.al/News/Index/10100> Postuar më, 27/05/202.

"Kuvendi mbledhet në seancë plenare; miratohen tre projektrezoluta, tre akte normative, katër projektligjet e paketës penitenciare dhe një projektvendim. Votohen kundër një projektligj dhe dy dekrete të Presidentit". <http://parlament.al/News/Index/10194> Postuar më, 25/06/2020.

"Kuvendi në seancë plenare, miratohen dy projektligje, rrëzohet dekreti presidencial dhe votohen kundër dy nisma ligjore deputetësh". <https://www.parlament.al/News/Index/10260> Postuar më, 16/07/2020.

Kuzio, T. (2002), "National Identity and Democratic Transition in Post-Soviet Ukraine and Belarus: A Theoretical and Comparative Perspective." *East European Perspectives*. Volume 4, Number 15.

"Ligji i ri për lustracionin/ Nisma e 20 deputetëve për të larguar nga politika funksionarët në komunizëm" Marrë nga: <https://top-channel.tv/2020/04/24/ligji-i-ri-per-lustracionin-nisma-e-20-deputeteve-per-te-larguar-nga-politika-funksionaret-ne-komunizem/> 24 Prill 2020.

Lipset, S. (1959), "Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy," *The American Political Science Review*, 53 (1), 69-105.

"Lustrimi" synon goditjen e sistemit të drejtësisë..." <http://www.arkivalajmeve.com/Lustrimi-synon-goditjen-e-sistemit-te-drejtësisë.158036/> 15 dhjetor 2008.

Magara, I. (2016), "Transitional justice and democratization nexus: Challenges of confronting legacies of past injustices and promoting reconciliation within weak institutions in Kenya." ACCORD (African Center for the Constructive Resolution of Disputes).

Majko, P (2008), fjalim si ligjvënës opozitar në Parlamentin e Shqipërisë kur po diskutoheshin tre iniciativat ligjore për lustracionin e figurave publike në komisionet parlamentare të Ligjeve, Administratës Publike dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut, dt. 07 Korrik, f. 27.

Marginean, I. (1997), "Indicators of Democratization in Romania," *Social Indicators Research* Vol. 42, Issue 3, pp. 353-366.

Mejdini, Fatjona & Marija Ristic. (2018), "Digging for Truth in Communist Albania's Secret Files." *Balkan Transitional Justice*. Downloaded from: <https://balkaninsight.com/2018/03/01/digging-for-truth-in-communist-albania-s-secret-files-02-28-2018/>

Merkel, W. (1998), "The Consolidation of Post-Autocratic Democracies: A Multi-level Model," *Democratization*, 5:3, pp.33-67.

Minow, M. (1998), *Between Vengeance and Forgiveness: Facing History after Genocide and Mass Violence*. Boston: Beacon Hill Press.

Muddell, K. & Sibley Hawkins. (2018), *Gender and Transitional Justice: A Training Module Series. Module 3: Reparative Justice*. International Center for Transitional Justice.

Nathan, B. (2018), "To Hell and Back." *The New York Review of Books*. Dec. 6-19, Volume LXV, Number 19.

Orentlicher, D. (1991), "Settling Accounts: The Duty to Prosecute Human Rights Violations of a Prior Regime," *Yale Law Journal* 100, no. 8: 2537-2615.

O'Donnell, G. et al. (1986), *Transitions from Authoritarian Rule: Comparative Perspectives*. Johns Hopkins University Press.

Pejic, J. (2019), "All Western Balkans Countries Need Priebe Reports" to Measure State Capture," *European Western Balkans*. 8 February. Downloaded from: <https://europeanwesternbalkans.com/2019/02/08/priebe-report-state-capture-western-balkans/>

Piasecka, A. and Oleksandra Drik. (2015). "Current challenges of lustration in Ukraine." *Open Dialogue*. 8 June. Downloaded from: <https://en.odfoundation.eu/a/6507,current-challenges-of-lustration-in-ukraine/>

Roht-Arriaza, N. (1990), "State Responsibility to Investigate and Prosecute Grave Human Rights Violations in International Law," *California Law Review* 78. 2 (1990): 449-513;

Roht-Arriaza, N. and Javier Mariezcurrena, eds. (2006), *Transitional Justice in the Twenty-First Century: Beyond Truth Versus Justice*. Cambridge: Cambridge University Press.

Rotberg, R. I. and Dennis Thompson, eds. (2000), *Truth v. Justice: The Morality of Truth Commissions*. Princeton: Princeton University Press.

Roche, D. (2007), "Retribution and restorative justice," in *Handbook of Restorative Justice*, ed. Gerry Johnstone and Daniel W. Van Ness. Portland, OR: Willan Publishing.

Saxonberg, S. & Jonas Linde. (2003), "Beyond Transitology: Area Studies Debate," *Problems of Post-Communism*, Vol. 5, pp. 3-16.

Schelder, A. (1998), *What is Democratic Consolidation?* <https://muse.jhu.edu/article/16883>

Schumpeter, Joseph A. 2014 [1942]. *Capitalism, socialism and democracy* (2nd ed.). Floyd, Virginia: Impact Books.

Stan, L. (2014), "Determinants of Post-Communist Transitional Justice: An Overview." Paper prepared for the Global Challenges Conference "Justice and Imagination: Building Peace in Post-Conflict Societies," Mount Holyoke College, February 28-March 1.

Stan, L. (2013), "Civil Society and Post-communist Transitional Justice in Romania." Chapter 2.

O. Simić and Z. Volčič (eds.), *Transitional Justice and Civil Society in the Balkans*, Springer Series in Transitional Justice, Springer Science+Business Media New York.

Stan, Lavinia. (2012), *Transitional Justice in Post-Communist Romania: The Politics of Memory*. Cambridge University Press.

Stan, Lavinia. (2009), "Truth Commissions in Post-Communism: The Overlooked Solution?" *The Open Political Science Journal*, No.2, 1-13.

Stan, L. ed. (2009), *Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union: Reckoning with Communist Past*. BASEES/ Routledge Series on Russian and East European Studies.

Ștefănescu, D. (1995), *Cinci ani din istoria României. O cronologie a evenimentelor decembrie 1989-decembrie 1994*. Bucharest: Editura Mașina de Scris.

Stover, E. and Harvey M. Weinstein, eds. (2004), *My Neighbor, My Enemy: Justice and Community in the Aftermath of Mass Atrocity*. Cambridge: Cambridge University Press.

Stepan, A. & Juan Linz. (1996), *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*. Johns Hopkins University Press.

Tarifa, Fatos. (1997), "The Quest for Legitimacy and the Withering Away of Utopia", *Social Forces*, Vol. 76, No. 2.

Taylor, P. (2019), "EU Faces Poland Test." *Politico*. Downloaded from: <https://www.politico.eu/article/poland-article-7-test-for-eu-on-rule-of-law/> July 6

Teitel, Ruti G. 2002. *Transitional Justice*. Oxford University Press.

Thoms, O.N.T., James Ron & Roland Paris. 2010. "State-Level Effects of Transitional Justice: What Do We Know?" *International Journal of Transitional Justice*, Volume 4, Issue 3.

Transparency International Albania. (2018), <https://www.transparency.org/country/ALB>

Zehr, H. (2002), *The Little Book of Restorative Justice*. Intercourse, PA: Good Books.

Vesnic-Alujevic, L. (2012), "European Integration of Western Balkans: From Reconciliation to European Future." *Center for European Studies*. Brussels: CES.

Vierita, A. (2012), *Romania's Communist Past*. Downloaded from: <https://www.nytimes.com/2012/03/05/opinion/romania-communist-past.html>

Vitvitsky, Bohdan. 2014. Comments on the Ukrainian Draft Law on Lustration. Vox Ukraine. August 25. Marrë nga: <https://voxukraine.org/en/comments-on-the-ukrainian-draft-law-on-lustration/>

Williams, Kieran. 2007. "Explaining lustration in Central Europe: a 'post-communist politics' approach." *Journal of Democratization*. Vol. 12, pp.22-43.

Wiebelhaus-Brahm, E. (2010), *Truth Commissions and Transitional Societies: The Impact on Human Rights and Democracy*. New York: Routledge, 2010.

